Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AMMK

RAPORT VJETOR

PËR GJENDJEN E MJEDISIT NË KOSOVË

2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TE KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

AMMK

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, 2017

Prishtinë, 2018

Të nderuar lexues,

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka kënaqësinë të ndajë me ju Raportin Vjetor për Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2017.

Raporti është përgatitur në kuadër të aktiviteteve për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore që ka AMMK për raportim të rregullt për gjendjen e mjedisit.

Raporti përmban kryesisht të dhëna nga monitorimi i gjendjes së mjedisi por edhe të dhëna nga projekte, publikimi dhe dokumente tjera relevante për mjedisin.

Pjesë e raporti janë edhe të dhënat nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare që kanë përgjegjësi të caktuara në sektorin e mjedisit dhe që ofrojnë të dhëna nga ky sektor.

Me këtë rast në emër të AKMM, shpreh falënderim dhe mirënjohje të gjithë atyre që kontribuuan në finalizimin e këtij dokumenti, qoftë përmes ofrimit të të dhënave të nevojshme ose duke dhënë sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Ne i vlerësojmë, çmojmë dhe mirëpresim të gjitha angazhimet, vërejtjet dhe sugjerimet e institucioneve, ekspertëve, OJQ-ve mjedisore dhe dashamirësve të mjedisit, të cilat do të na ndihmojnë gjatë hartimit të publikimeve të ardhshme, për ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së tyre.

Shpresojmë që ky raport do të jetë një kontribut modest, jo vetëm për informimin real për gjendjen e mjedisit në Kosovës por edhe një dokument që do ti shërbejë politikbërësve në zbatimin e politikave të qëndrueshme mjedisore dhe donatorëve në orientimin e projekteve të ardhshme.

Dr.sc. Ilir Morina, *Kryeshef Ekzekutiv i AMMK-së*

Përmbajtja

Hyrje 4

1. Gjendja e mjedisit 5
1.1. Ajri 5
1.2. Uji 22
1.3. Toka 38
1.4. Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura 41
1.5. Mbeturinat 45
1.6. Shëndeti publik 54

2. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit 61
2.1. Përafrimi i legjislacionit mjedisor kombëtar me Direktivat e BE-së 61
2.2. Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve mjedisore 63
2.3. Zhvillimet dhe ngecjet institucionale 65
2.4. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të Ligjit 66
2.5. Lejedhënia 68
2.6. Investimet në mbrojtjen e mjedisit 69

3. Të gjeturat dhe rekomandimet 72
3.1. Të gjeturat kryesore të raportit 72
3.2. Rekomandimet 75

4. Referencat 78

5. Lista e shkurtesave, figurave dhe tabelave 79

6. Shtojcat 84

Hyrje

Hartimi i Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit[1]. Sipas nenit 25, të këtij ligji, Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i paraqet Kuvendit Raport për Gjendjen e Mjedisit.

Raporti duhet të përmbajë të dhëna për:

- gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm,
- ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës,
- gjendjen e mjediseve të rrezikuara,
- zbatimin e strategjisë së mjedisit dhe planit të veprimit,
- masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit,
- zhvillimin e institucioneve mjedisore dhe
- financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, është institucioni që harton këtë dokument.
Ky Raport vjetor paraqet gjendjen e mjedisit për vitin 2017, por edhe të dhëna të mëhershme zënë vend të konsiderueshëm me qëllim krahasimi.
Për hartimin e raporti, AMMK ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, kompanitë, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative mjedisore që tani janë prezantuar në këtë raport.

Prezantimi i gjendjes për disa sektorë mjedisor është më pak i mbuluar si pasojë e mungesës së të dhënave, mungesës së monitorimit, bazës ligjore të pamjaftueshme apo dhe dobësive tjera institucionale e menaxhuese.

Cilësia e këtij raporti, deri në një masë është edhe reflektim i cilësisë së monitorimit që zbatohet në shkallë vendi dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor. Këto dy sisteme mjedisore ende janë në fazën e ngritjes dhe fuqizimit andaj ende ka mungesë të dhënave të plota dhe të besueshme.

Qëllimi kryesore këtij raporti, është, informimi për gjendjen e mjedisit në Kosovë mirëpo, të dhënat e tij janë një bazë e mirë që mundë të shërbejnë edhe për hartimin e politikave adekuate mjedisore dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis siç janë: ekonomia, industria, energjetika, transporti, bujqësia etj.

[1] Ligji Nr. 03/L-025

1. Gjendja e mjedisit

1.1. Ajri

1.1.1. Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit në këtë raport pasqyron gjendjen për territorin e Kosovës duke u bazuar në matjet nga stacionet për monitorim e vazhdueshëm të cilësisë së ajrit. Burim i të dhënave janë kryesisht raportet mujore, që prezantojnë të dhënat e regjistruara nga stacionet të cilat janë nën menaxhimin e IHMK.

Dy nga stacionet e vendosura në Prishtinë janë reprezentative për cilësinë e ajrit ne sfondin urban (Rilindja) dhe në sfondin suburbane (IHMK), ndërsa 6 stacionet tjera të vendosura në Mitrovicë, Drenas, Pejë, Prizren, Hani i Elezit, Gjilan, janë reprezentative për cilësinë e ajrit në sfondin urban dhe stacioni i vendosur në Brezovicë është për sfondin rural. Ndërsa 3 stacione të sfondit industrial janë vendosur në zonën e KEK-ut (Dardhishtë, Palaj dhe Obiliq). (Tabela 1)

Tabela 1 . Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit

Nr.	Emërtimi i stacionit monitoruues	Kodi i stac.	Lokacioni	Institucioni përgjegjës	Parametrat që maten	Tipi i zonës
1	IHMK	KS0101	IHMK,Prishtinë	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2, NO_x,O_3,CO	Sfondi Urban/traffik
2	Rilindja	KS0102	Oborri i Rilindjes, Prishtinë	IHMK	PM10,PM2.5,03	Sfondi urban
3	Pejë	KS0305	Sh. fillore "Lidhja e Prizrenit"	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2, NO_x,O_3,CO	Sfondi urban
4	Prizren	KS0406	Kuvendi Komunal	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,	Sfondi urban
5	Brezovicë	KS0507	Zona e skijimit	IHMK	PM10,PM2.5,	Sfondi sub urban
6	Hani i Elezit	KS0508	Sh.fillore "Ilaz Hallaqi"	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi urb./in.
7	Gjilan	KS0609	Kuvendi Komunal	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi urban/traffik
8	Drenas	KS0103	Kuvendi Komunal	IHMK	PM10,PM2.5 ,SO_2,NO_x,CO	Sfondi urban
9	Obiliq	KS0110	QMF	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi urban

10	Dardhishtë	KS0111	Shkolla fillore	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi industrial
11	Palaj	KS0112	Kosova Mont	IHMK	PM10,PM2.5,SO_2,NO_x,O_3,CO	Sfondi industrial
12	Mitrovicë	KS0204	Stacioni i meteorologjisë	IHMK	CO,O_3,PM10,PM2.5	Sfondi urban

Raporti përfshin vlerat mesatare mujore nga rezultatet e sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit në stacionet e rrjetit nacional.

Normat e cilësisë së ajrit në bazë të së cilave është bërë vlerësimi janë të bazuara në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011, (Tabela 2).

Tabela 2. Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimi Administrativ Nr.02/2011.

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite (kufitare) µg/m³	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m³	30	Nuk parashihet
SO2	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore te maksimales 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m³	10	Nuk parashihet
PM10	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	50	35
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	40	Nuk parashihet
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	25	Nuk parashihet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m³	120	Nuk parashihet
	Pragu i informimit	µg/m³	180	Nuk parashihet
	Pragu i alarmit	µg/m³	240	Nuk parashihet

Vlerësimi i cilësisë së ajrit gjatë vitit 2017 bazuar në të dhënat nga IHMK

Vlerësimi përfshin vlerat mesatare mujore dhe të njëjtat krahasohen me Vlerat maksimale të Lejuara (VML) sipas U.A.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit.

Në këtë raport pasqyrohet gjendja e cilësisë së ajrit për vitin 2017, rezultate këto te monitoruara nga stacionet monitoruese të IHMK-së për cilësi te ajrit.
Raporti përfshin vlerat mesatare mujore si një vlerësim i përgjithshëm të gjendjes së ajrit në Kosovë, bazuar në rezultatet e mbledhura nga matjet automatike të parametrave ndotës të ajrit. Të dhenat janë përpunuar dhe në këtë raport është dhënë një vlerësim të gjendjes së cilësisë së ajrit sipas zonave të monitorimit.

Vlerësimi i gjendjes së cilësisë së ajrit prezanton krahasimin e vlerave të rezultateve të fituara me vlerat standard të lejuara sipas ligjeve dhe rregulloreve vendore në fuqi dhe sipas Direktivës 2008/50 EC, për cilësi të ajrit (Tab.2.) Vlerësimi përfshin vlerat mesatare mujore dhe të njëjtat krahasohen me Vlerat maksimale të Lejuara (VML) sipas U.A.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit.

SO_2 (Dioskidi i sulfurit) - Nga të dhënat për matjen e përqendrimit të SO_2 (nga të gjitha stacionet monitoruese), nuk ka asnjë tejkalim të VML (Vlerës Maksimale të Lejuar) gjatë gjithë periudhës janar-dhjetor 2017. Në fig.1. janë paraqitur vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të SO_2 (Dioskidi i sulfurit). Vlerat mesatare vjetore në të gjitha stacionet kanë qenë nën VML, gjatë tërë vitit.




Fig.1. Vlerat mesatare mujore dhe vlerat maksimale te lejuara të SO_2

CO (Monoksidi i karbonit)- Nga të dhënat për matjen e përqendrimit të CO nga stacionet që kanë monitoruar këtë parametër, nuk ka asnjë tejkalim të VML (Vlerës Maksimale të Lejuar) gjatë gjithë periudhës janar-dhjetor 2017. Në fig.2. janë paraqitur vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të CO (Monoksidit të karbonit). Siç shifet nga grafikoni nuk regjistruar tejkalime të vlerave mesatare vjetore të CO, nga të gjitha stacionet monitoruese sipas VML.




Fig.2. Vlerat mesatare mujore dhe vlerat maksimale te lejuara të CO

NO_2 (Dioksidi i azotit)- Nga të dhënat për matjen e përqendrimit NO_2, gjatë periudhës janar-dhjetor 2017 kishte ngritje të lehta të VML dhe atë në stacionin monitorues në IHMK, Rilindje, Obiliq, Dardhishtë, Gjilan dhe në Han të Elezit. Në fig.3. janë paraqitur vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të NO_2 (Dioksidi i Azotit), çka tregon se nuk janë regjistruar tejkalim te vlerave mestarë vjetore të NO_2, në asnjë nga stacionet monitoruese për vitin 2017.




Fig.3. Vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të NO_2

O_3 (Ozoni)- Nga të dhënat për matjen e përqendrimit O_3, gjatë periudhës janar-dhjetor 2017 nuk kishte tejkalime të VML, në asnjërën prej stacioneve monitoruese. Në fig.4. janë paraqitur vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të O_3 (Ozoni). Siç shihet edhe nga figura se nuk ka patur tejkalim te vlerave mesatare vjetore të NO_2, nga të gjitha stacionet monitoruese për vitin 2017. Një përafrim me VML është regjistruar në dy stacionet monitoruese ne Prishtinë dhe në Gjilan.




Fig.4. Vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të O_3

PM10 (Grimcat e pluhurit) - Gjatë viti 2017, nga të dhënat për matjen e përqendrimit të PM10, kishte tejkalime të VML si mesatare mujore dhe vjetore. Në bazë të tejkalimeve te vlerave mesatare mujore janë te regjistruar si:

- Obiliq dhe Dardhishtë - 8 muaj
- Prishtinë-IHMK dhe Rilindje - 4 muaj,
- Drenas dhe Mitrovicë - 6 muaj dhe
- Gjilan- 1 muaj.

VML për PM10 është: 40 µg/m^3 (Vlera Maksimale e Lejuar vjetore) dhe 50 µg/m^3 (Vlera Maksimale e Lejuar për 24 orë të monitorimit kontinual).

Në fig.5. janë paraqitur vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të PM10. Sipas grafikonit vërehet se vlerat mesatare vjetore të PM10, në Drenas, Gjilan, Obiliq dhe Dardhishtë ka patur tejkalim mbi VML.




Fig.5. Vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të PM10

PM2.5 (Grimcat e Pluhurit)- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2017, kishte tejkalime të theksuara të VML për PM2.5 në Prishtinë –IHMK dhe Rilindje (janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor), Drenas dhe Mitrovicë (janar, shkurt dhe nëntor), Palaj (nëntor). Në stacionet monitoruese në Obiliq dhe Dardhishtë janë regjistruar tejkalime pothuaj në të gjithë muajt e vitit.

VML për PM2.5 është 25 µg/m^3 si Vlerë e Lejuar Maksimale për mesataren vjetore. Kjo VML merret si VML edhe për mesataren 24-orëshe.

Në fig.6. janë paraqitur vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të PM2.5. Sipas grafikonit vërehet se vlerat mesatare vjetore të PM2.5, në Prishtinë-IHMK, Prishtinë-Rilindje, Drenas, Mitrovicë, Obiliq dhe Dardhishtë janë regjistruar tejkalim mbi VML.




Fig.6. Vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të PM10

Vlerësimi i cilësisë së ajrit PM10 dhe PM2.5 (grimcave te pluhurit), sipas stacioneve matëse për vitin 2017

Duke analizuar të dhënat e IHMK nga stacionet monitoruese për cilësi të ajrit, gjatë vitit 207, prezantohen vetëm trendi i përqendrimit të PM10 dhe PM2.5 në 11 stacionet monitoruese.

Për dy stacionet monitoruese në IHMK dhe në oborrin e Rilindjes, gjatë vitit 2017 kishte tejkalime të VML si për PM10 ashtu edhe për PM2.5. Këto tejkalime ishin të theksuara në muajt janar, mars, shkurt, tetor, nëntor dhe dhjetor (fig.7,8). VML[2] për PM10: 40 µg/m^3; VML[3] për PM2.5: 25 µg/m^3.




Fig.7. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Prishtinë/IHMK




Fig.8. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Prishtinë/Rilindja

[2] *VML -Vlera Maksimale e Lejuar për PM10, mesatare vjetore sipas UA 02/2011 për normat e cilësisë së ajrit*
[3] *VML-Vlera Maksimale e Lejuar për PM2.5, mesatare vjetore sipas UA 02/2011 për normat e cilësisë së ajrit*

Në tri stacionet monitorues të vendosura në zonën e ndikuar nga aktivitetet e KEK-ut (Obiliq, Palaj dhe në Dardhishtë), kishte tejkalime të VML për PM10 dhe PM2.5 edhe në muajt korrik, gusht e shtator, si rezultat i emisioneve nga Termocentralet Kosova A dhe TC Kosova B dhe aktivitetet tjera si nxjerrja e lignitit, transporti dhe deponimi i tij. Ky fakt argumentohet nga të dhënat nga emisionet e pluhurit, SO_2 dhe NO_x, të cilat janë pjesë e këtij raporti.




Fig.9. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Obiliq




Fig10. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Dardhishtë




Fig.11. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Palaj

Edhe në grafikun e prezantuar nga stacioni monitorues në Drenas, përveç sezonës së vjeshtë-dimër-pranverë, kishte tejkalime të përqendrimit të pluhurit në formë të PM10 dhe PM2.5 (qershor, korrik dhe gusht). Vlerësohet se vlerat mbi VML janë rezultat i aktiviteteve të Feronikelit, transportit rrugor dhe amvisërive, të cilat gjatë sezonit të ngrohjes përdorim lëndë djegëse që liriojnë emisione, të cilat shkaktojnë ndotjen e ajrit (Fig.12).




Fig.12. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Drenas

Nga të dhënat e siguruara në stacionin monitorues të cilësisë së ajrit në Han të Elezit vërehet tejkalim i VML të PM10 për muajin dhjetor dhe të PM2.5 në muajin tetor, nëntor dhe dhjetor. Edhe këtu konsiderohet se fabrika e Cementit Sharrcem është kontribuuesi kryesor i ndotjes së ajrit (fig.13).




Fig.13. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Han të Elezit

Nga grafiku 14, i cili paraqet cilësinë e ajrit në Mitrovicë, vërehet tejkalim i VML kryesisht për PM2.5 (janar, shkurt, mars, korrik dhe nëntor) dhe në dy muaj tejkalim i vlerave të lejuara maksimale të PM10 (janar dhe gusht).




Fig.14. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Mitrovicë

Nga grafiku 15, i cili paraqet cilësinë e ajrit në Gjilan, vërehet tejkalim i VML kryesisht për PM2.5 në dhjetor dhe në nëntor, ndërsa në muajin dhjetor janë regjistruar tejkalime të vlerave të lejuara maksimale të PM10.




Fig.15. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Gjilan

Nga grafiku 16, i cili paraqet cilësinë e ajrit në Pejë, vërehet tejkalim i VML kryesisht për PM2.5 vetëm në muajin nëntor, ndërsa për PM10 nuk kemi tejkalim të vlerave mesatare të PM10 në asnjërin prej muajve të vitit.




Fig.16. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Pejë

Në stacionin monitorues në Prizren nuk janë regjistruar tejkalim të VML për PM10 dhe PM2.5 (fig.17).




Fig.17. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Prizren

Trendi i cilësisë së ajrit 2012-2017

Siç vërehet nga fig.18. vlerat e regjistruara të SO_2, gjatë 2012-2017 kanë qenë të ndryshme. Vlerat më të larta e vërehet të jetë gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017. Vlerat limite për 24 ore për mbrojtën e shëndetit duhet te jete deri 125 µg/m³. Ndotja me e lart nëpër vite për këtë parametër është në Obiliq, Drenas, Prizren dhe Han të Elezit.




Fig.18. Trendi i vlerave të Dioksidit të sulfurit (SO_2)

Në fig.19. është prezantuar trendi i NO_2, nga ku vërehe se ky trend është luhatur prej vitit në vit. Vërehet se gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017 ky ndotës ka vlera më të larta veçanërisht në stacionet e vendosura në Prishtinë, Obiliq, Gjilan, Han të Elezit. Vlera limite vjetore për mbrojtën e shëndetit të njeriut është 40 µg/m³. Në bazë te mesatares vjetore nuk janë regjistruar tejkalim të NO_2, në asnjërën prej stacioneve.




Fig.19. Trendi i vlerave të Dioksidit të azotit (NO_2)

Në fig. 20 vërehet se trendi i rritjes se ozonit është më i lartë në stacionin e Prizrenit dhe Hanit te Elezit për vitet 2013, 2015, 2016. Në rastet e regjistrimit të vlerave prej 180 µg/m^3 duhet te aktivizohet pragu i informimit.




Fig.20. Trendi i vlerave të Ozonit (O_3)

Në fig.21 vërehet se trendi i monoksidit te karbonit është me vlera më të larta në stacionin e Prishtinës (IHMK), Obiliq, Pejë dhe Prizren. Vlerat më të larta janë regjistruar për vitet 2015 dhe 2016. Vlerat limite për mesataret ditore është 10 mg/m^3.




Fig.21. Trendi i vlerave të monoksidit të karbonit (CO)

Në fig.22 prezantohet trendi i PM10, nga ku vërehet se për vlerat mesatare vjetore është e ndryshme nëpër stacionet monitoruese. Vërehet se prej vitit 2013-2017, në stacionet e vendosura në Prishtinë (Rilindja), Drenas, Obiliq, Gjilan dhe Han të Elezit, janë vlerat mesatare më të larta me PM10. Vlerat limite vjetore për mbrojtjen e shëndetit janë 40 µg/m^3 .




Fig.22. Trendi i vlerave të grimcave të pluhurit (PM10)

Në fig.23 shihet se trendi i PM2.5 për vlerat mesatarë vjetore është i ndryshëm nëpër stacionet monitoruese. Prej vitit 2013-2017, në të gjitha stacionet ka tejkalime të vlerave, por më të theksuara janë në Mitrovicë, Obiliq, Gjilan dhe Drenas. Vlerat limite vjetore për mbrojtjen e shëndetit janë 25 µg/m3.




Fig.23. Trendi i vlerave të grimcave të pluhurit (PM2.5)

1.1.2. Emisionet në ajër

1.1.2.1. Vlerësimi i emisioneve në ajër nga TC Kosova A dhe TC Kosova B

KEK është kompania publike e Kosovës, e cila ka në pronë dhe operon me asete të gjenerimit të energjisë elektrike dhe të mihjes së linjitit. Vlerësohet një ndër ndotësit më të mëdhenjtë në Kosovë.

Trendi i emisioneve në Termocentralet Kosova A dhe Kosova B, gjatë muajve Janar-Dhjetor, 2017

Vlerat limite sipas Direktivës 2001/80/EC, si dhe UA nr./2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e pa lëvizshme të ndotjes me djegie të madhe, janë si vijon:

- ✓ ***SO_2***.....*400 mg/Nm^3*
- ✓ ***NOx***.....*500 mg/Nm^3*
- ✓ ***Pluhur***.....*50 mg/Nm^3*

Në këtë kapitull janë prezantuar të dhëna grafike për emisionet e Pluhurit, SO_2 dhe NOx në Termocentralet Kosova A dhe Kosova B, Janar – Dhjetor 2017.
Parametrat e SO_2, NOx dhe CO_2 janë kalkuluar (përveç emisionit të pluhurit i cili matet). Në TCA, ndërsa në TC B janë vendosur analizatorët për matjen e vazhdueshme të emisioneve të pluhurit, SO2, NOx, dhe CO2. Sipas raporteve të KEK, gjatë vitit 2017 ka pasur ngecje në funksionimin e këtyre paisjeve.

Emisionet e Pluhurit në mg/Nm^3- Në fig. 24 janë paraqitur emisionet e pluhurit në TC A dhe në TC B. Nga të dhënat e prezantuara shihet se në TC A nuk ka patur tejkalim gjatë muajve Janar – Dhjetor ndërsa në TC B vlerat e pluhurit kanë qenë mbi normat e lejuara.




Fig.24. Emisionet e pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017

Emisionet e SO_2 në mg/Nm^3- Në fig.25. janë paraqitur emisionet e SO_2 në TC A dhe në TC B. Sikurse vërehet edhe nga të dhënt e prezantuara në TC A nuk ka tejkalime të theksuara kurse në TC B shihet se gjatë muajve Janar, Shkurt, Maj, Qershor, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor ka pasur tejkalim të vlerave të SO_2.




Fig.25. Emisionet e SO_2 në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017

Emisionet e NOx në mg/Nm^3- Në fig.26, janë paraqitur emisionet e NOx në TC A dhe në TC B. Të dhënat flasin se në të dy termocentralet ka tejkalime të vlerave të NOx gjatë muajve Janar – Dhjetor 2017.




Fig.26. Emisionet e NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017

1.1.2.2. Vlerësimi i emisioneve në ajër nga NewCoFeronikeli

Feronikeli gjatë procesit të prodhimit liron emisionet ndotëse si në ajër ashtu edhe në ujë. Emisionet ne ajër lirohen veçanërisht nga furrat rrotulluese, furrat elektrike, konvertori dhe ngrohtorja.
Në vijim janë të paraqitur në mënyrë grafike emisionet e Pluhurit, SO_2 dhe NOx të matura në Feronikel, gjegjësisht në:

- ✓ Oxhakun e furrave rrotulluese;
- ✓ Oxhaku e konvertorëve;
- ✓ Furra elektrike nr.1. pas skruberit;

Oxhaku i furrave rrotulluese

Emisionet e matura të Pluhurit në mg/Nm^3- Në fig.27, janë paraqitur emisionet e pluhurit në Oxhakun e furrave rrotulluese të Feronikelit, nga shihet se nuk ka tejkalime të vlerave të lejuara gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.




Fig.27. Emisionet e matura të pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i furrave rrotulluese

Emisionet e matura të SO_2 në mg/Nm^3- Në fig.28. janë paraqitur emisionet e SO_2 në Oxhakun e furrave rrotulluese në Feronikël. Të dhënat tregojnë se gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 nuk janë regjistruar tejkalime të vlerave të lejuara.




*Fig.**28.** Emisionet e matura të SO_2 në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i furrave rrotulluese*

Emisionet e matura të NOx në mg/Nm^3- Nga të dhënat e prezantuara në fig.29. ku janë paraqitur emisionet e NOx në Oxhakun e furrave rrotulluese në Feronikel, vërehet se gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017, janë regjistruar vlera më të ulëta në krahasim me vlerat e lejuara.




Fig.29. Emisionet e matura të NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i furrave rrotulluese

Oxhaku i konvertorit

Emisionet e matura të Pluhurit në mg/Nm3- Në fig.30. janë paraqitur emisionet e pluhurit në Oxhakun e konvertorit në Feronikël. Sipas grafikut vërehet se nuk ka tejkalime nga vlerat e lejuara gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.




Fig.30. Emisionet e matura të pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i konvertorit

Emisionet e matura të SO2 në mg/Nm3- Në fig.31. janë paraqitur emisionet e SO_2 në Ferronikel, gjegjësisht në Oxhakun e konvertorit, nga shihen se gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 nuk ka patur tejkalime nga vlerat e lejuara.




Fig.31. Emisionet e matura të SO_2 në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i konvertorit

Emisionet e matura të NOx në mg/Nm3 - Në fig.32. janë paraqitur emisionet e NOx në Oxhakun e konvertorit nga shihet se gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit janë regjistruar vlera më të ulëta në krahasim me vlerat e lejuara.




Fig.32. Emisionet e matura të NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i konvertorit

Furra elektrike nr.1 pas skruberit

Emisionet e matura të pluhurit në mg/Nm^3- Në këtë pikë bëhet vetëm monitorimi i emisioneve të pluhurit. Në fig.33. janë paraqitur emisionet e pluhurit në Ferronikel, gjegjësisht në Furrën elektrike nr.1 pas skruberit, nga shihet se nuk ka tejkalime nga vlerat e lejuara gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.




Fig.33. Emisionet e matura të pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Furra elektrike nr.1 pas skruberit

1.1.2.3. Vlerësimi i emisioneve në ajër nga Sharrcem

Procesi teknologjik i përfitimit të çimentos në të gjitha fazat e prodhimit është i përcjellë në masë të madhe apo të vogël me faktorë të cilët ndikojnë në mjedis. Ndikimet kryesore në mjedis nga industria e çimentos janë shkarkimet ne ajër. Shkarkime të emisioneve ne ajër i, (pluhur, NOx, SO_2) vijnë si rezultat i proceseve te djegies në furrën rrotulluese. Këto emisione burojnë pjesërisht prej zbërthimeve fiziko–kimike të lëndës së parë dhe pjesërisht prej procesit të djegies së lëndës djegëse.

Në vijim janë paraqitur në mënyrë grafike emisionet e Pluhurit, SO_2 dhe NOx. Nuk ka matje për muajin shkurt, për shkak se gjatë këtij muaji nuk ka pasur prodhim si pasojë e renovimeve në këtë operator.

Emisionet e Pluhurit në mg/Nm3- Në fig.34. janë paraqitur emisionet e pluhurit në Sharrcem, gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017. Të dhënat tregojnë se vlerat janë shumë të ulëta dhe nuk janë regjistruar tejkalime të normave të lejura.




Fig.34.Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.

Emisionet e SO_2 në mg/Nm3- Në fig.35. janë paraqitur emisionet e SO_2 në Sharrcem, nga shihen se vlerat janë shumë të ulëta gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.




Fig.35.Vlera mesatare mujore e emisioneve të SO_2 në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.

Emisionet e NOx në mg/Nm3- Sikurse është prezantuar në fig.36. ku janë paraqitur emisionet e NOx në Sharrcem, vërehet se nuk ka tejkalime gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.




Fig.36.Vlera mesatare mujore e emisioneve të NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.

1.2. Uji

Zhvillimi industrial, urbanizimi, bujqësia intensive janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ujërave. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve tona ujore.

Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik. në trupat ujorë. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç'rast vije deri tek rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH_4^+ etj.) dhe atyre organike (PCB, Herbicide etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujorë janë shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore

Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bënë Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vendmostrime (stacion monitoruese). Parametrat fizik që aktualisht monitorohen janë 10 parametra fizikë (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Në shtojcën 1 dhe 2 të raportit, janë prezantuar stacionet monitoruese të lumenjve, parametrat që monitorohen dhe frekuenca e matjeve.

Në këtë raport gjendjen e ujërave është pasqyruar përmes si treguesve (parametrave): Oksigjeni i tretur (mg/l O_2); Shpenzimi biokimik i oksigjenit- $SHBO_5$ (mg/l O_2), Shpenzimi kimik i oksigjenit- SHKO (mg/l O_2); Karboni organik total-C (mg/l); Fosfori total – P (mg/l), Materiet totale të suspenduara-MTS (mg/L). Vlerat e prezentuara në grafikon janë si vlera mesatare për vitin 2017.

Parametrat si: oksigjeni i tretur (O2), oksigjeni biokimik i shpenzuar për 5 ditë ($SHBO_5$), shpenzimi kimik i oksigjenit (SHKO), tregojnë nivelin e ndotjes organike dhe bakteriologjike të ujit i cili hynë në grupin e parametrave të cilët pritet të kenë presione nga ato dukuri që u cekën më lartë. Derisa, prezenca e fosforit (P_{tot}) shkakton eutrofikimin në ujëra.

Pellgu i Drinit të Bardhë – Në këtë pellg përzgjedhja është bërë për dy lumenjët: lumi Drini i Bardhë dhe lumi Ereniku, ku si vlera mesatare vjetore të ngritura paraqiten shpenzimi kimik i oksigjenit /mg/l O_2 (SHKO) dhe atë në dy lumenjët e stacioneve monitoruese përgjatë rrjedhjes duke përjashtuar stacionet referente (vendburimet).




Figura 37: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjëve- IHMK 2017 (Pellgu i Drinit të Bardhë)

Pellgu i Ibrit – Në këtë pellg përzgjedhja është bërë për këta lumenjë: Ibri, Sitnica, Prishtevka, Graqanka dhe Drenica (figura 38), nga ku vërehet se lumi Prishtevka/Bresje, pothuajse me të gjithë parametrat e paraqitur tregon vlera më të ngritura, ngase vetë shtrirja e lumit është përgjatë zonës më të populluar dhe që përfshinë edhe zonat industriale.




Figura 38: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjëve- IHMK 2017(Pellgu i Ibrit)

Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit - Në pellgun Morava e Binçës është përzgjedhur lumi Morava e Binçës me gjithësej katër stacione monitoruese (figura 39), ku pothuajse në të gjitha stacionet monitoruese ka ngritje të këtyre gjashtë parametrave. Ndërsa në Pellgun Lepencit, janë përzgjedhur dy lumenjë: ai i Lepencit dhe Nerodimja.




Figura 39: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjëve- IHMK 2017 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit)

Bazuar në këto tri grafikone (shtrirjen teritoriale në të gjitha pellgjet) ku prezenca e sasisë së fosfori total/ mg/l P nga analizat e bëra gjatë kësaj periudhe tregojnë se sasia e fosforit në ujërat e lumenjve nuk do të paraqesin ndikim të shprehur në ujërat sipërfaqësore, sepse vlerat e tij të paraqitura në diagramet gjendet në mes 0.02 mg/l P (Drenica/ Pjetërshticë) dhe 4.05 mg/l P (Prishtevka/Bresje). Nga konstatojmë se ujërat sipërfaqësore në Kosovës nuk janë të rrezikuar me eutrofikim.

Poashtu, edhe treguesi shpenzimi biokimik i oksigjenit ($SHBO_5$), gjatë periudhës së monitorimit për vitin 2017, vlerat e përllogaritura gjenden në mes të 1.73 mg O_2/l (Lepenci/ Prevallë Subain) dhe 74.22 mg O_2/l , që tregon për ndotje me vlerën më të lartë mesatare vjetore në lumin Prishtevka/Bresje. Edhe pse në kushte natyrore ujërat e pastra nuk posedojnë fare sasi të $SHBO_5$, por kjo ndotje arsyetohet me faktin që ujërat sipërfaqësore iu ekspozohen gjithnjë dhe gjithandej më shumë shkarkimeve të ujërave të ndotura përmes të cilave dhe krijohen kushte optimale për rritjen e vlerës së $SHBO_5$.

Për të ditur nëse gjendja e ujërave ka ndryshime nga viti paraprak në vitin 2017, në tabelën 3 është paraqitu trendi i cilësisë së ujërave për parametrat e përzgjedhur si në grafikonet e lartcekur.

Tabela 3: Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjve 2016-2017

Stacionet monitoruese	Oksigjeni i tretur/ mg/l O_2	Shpenzimi biokimik i oksigjenit/ mg/l O_2 ($SHBO_5$	Shpenzimi kimik i oksigjenit/ mg/l O_2 (SHKO)	Karboni organik total/ mg/l C	Fosfori total/ mg/l P	Materiet totale të suspenduara/ mg/L (MTS)
RV01_011	↓	↑	↑	↑	↓	↔
RV01_012	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV01_013	↑	↑	↑	↑	↑	↓
RV01_071	↓	↑	↑	↑	↓	↔
RV01_072	↑	↑	↑	↑	↓	↓
RV02_011	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV02_012	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV02_013	↑	↑	↑	↑	↑	↑
RV02_023	↓	↑	↑	↑	↓	↓
RV02_024	↓	↑	↑	↑	↓	↓
RV02_026	↑	↑	↑	↑	↓	↑
RV02_041	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV02_051	↑	↑	↓	↑	↓	↓
RV02_061	↑	↑	↑	↑	↓	↓
RV02_062	↓	↑	↑	↑	↓	↓
RV03_011	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV03_012	↑	↑	↑	↑	↑	↑
RV03_013	↑	↑	↑	↑	↑	↑
RV03_014	↑	↑	↑	↑	↓	↓
RV04_011	↑	↑	↑	↓	↓	↔
RV04_012	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV04_013	↓	↑	↑	↑	↓	↑
RV04_021	↑	↑	↑	↑	↓	↔
RV04_023	↑	↓	↓	↓	↓	↓
RV04_024	↑	↑	↓	↑	↓	↓

Monitorimi biologjik i ujërave sipërfaqësore

Zhvillimi i sistemeve të vlerësimit dhe klasifikimit ekologjik është një nga pjesët më të rëndësishme dhe teknikisht sfiduese në zbatimin e Direktivës Kornizë të Ujit (DKU). Statusi i mirë ekologjik i ujërave sipërfaqësor përcaktohet në Aneksin V të DKU, në aspektin e cilësisë së komunitetit biologjik, karakteristikat hidrologjike dhe karakteristikat kimike. Pasi që nuk mund të vendosen standarde absolute për cilësinë biologjike në të gjitha shtetet që synojnë implementimin e DKU dhe për shkak të ndryshueshmërisë ekologjike, kontrollet janë specifikuar të lejojnë vetëm një largim të lehtë nga komuniteti biologjik i cili do të ketë ndikim antropogjen.

Në kuadër të projektit: "Mundësimi i Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në Pellgun e Zgjeruar të Lumit Drin" i mbështetur nga GEF (Global Environmental Fascilities) dhe i implemetuar nga GWP (Global Water Partnership) është bërë monitorimi biologjik në Pellgun e Drinit të Bardhë në pesë stacione monitoruese:

- Stacioni Monitorues 1 - Lumi Drini i Bardhë në Radavc,
- Stacioni Monitorues 2 - Lumi i Klinës në Klinë,
- Stacioni Monitorues 3 - Lumi Toplluha në Piranë,
- Stacioni Monitorues 4 - Lumbardhi i Prizrënit në Vlashnje dhe
- Stacioni Monitorues 5 - Lumi Drini i Bardhë në Vërmicë.

Në kuadër të ktij monitorimi është bërë hulumtimi i Zoo Bentosit – Invertebrata (Pakurrizorët e ujit), dhe Monitorimi i Fito Bentos – Diatomet dhe Macrophytes.
Stacioni Monitorues 1 dhe Stacioni Monitorues 5 janë të vendosura përgjatë Lumit Drini i Bardhë, ndërsa, tre stacione të tjera monitoruese janë të vendosura përgjatë rrjedhjes së lumit Drini i Bardhë.

Macro Invertebrates – Bentik (pjesa fundore e lumit) makro (e madhe mjaftueshëm që të shihet me sy të lirë) invertebrates janë organizma ujorë që, në përgjithësi, janë të vegjël (do të mbahen me një rrjetë prej 200 deri në 500 μm), por mjaftueshëm të mëdha për t'u mbledhur lehtë. Macroinvertebrates jetojnë në substrate të poshtme të rrjedhave dhe liqeneve, për të paktën një pjesë të ciklit të jetë së tyre dhe jetojnë në të gjitha llojet e habitatit ujor. Në këtë grup përfshihen insektet, por edhe krimbat, karavidhet dhe kërmijtë e ujërave të ëmbël.

Monitorimi Phyto Benthos/Diatomet – Diatomet janë organizma fotosintetikë, eukariotike që banojnë pothuajse në të gjitha trupat e ujit. Ato gjenden në burime, lumenj, pellgje, liqene, kanale, në ujërat e ëmbla, ujërat e njelmëta dhe ato detare. Diatomet tradicionalisht janë të klasifikuara sipas formës së valvulave të tyre, të ndara në dy grupe të mëdha strukturore: diatomet centrikë (me valvula) që shfaqin simetri radiale) dhe diatomet pennate (me valvula që shfaqin simetri dypalëshe)

Monitorimi Phyto Benthos / Makrofite – Makrofitet janë një bimë ujore që rritet në ose afër ujit dhe janë të lira, të zhytur ose lundruese dhe përfshinë helophytes (një bimë që rritet në kënetë, pjesërisht e zhytur në ujë). Në liqenj dhe lumenj makrofitet sigurojnë substrate për invertabrates ujore, prodhojnë oksigjen dhe shërbejnë si ushqim për disa peshq dhe shtazë tjera. Struktura e bimësisë ujore në lumenj mund të ndryshojë si pasojë e pasurimit të lëndëve ushqyese dhe prezencës së ndotësve. Për më tepër, prezenca e makrociteve ujorë raportohet si përmirësim në cilësinë e ujit.

Rezultatet e monitorimit biologjik për makroinventebrorët janë prezantuar në tabelën 4.

Tabela 4: Rezultatet e monitorimit biologjik për makroinvetebrorët

	Radavc	Klinë	Toplluhë	Vlashnje	Vërmicë
Vlera e indexit EPT*[4]	22	20	12	16	8
Bioklasifikimi	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Mirë
Vlera e FBI*	1.97	3.78	5.19	3.97	6.01
Bioklasifikimi	Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	I varfër	Shumë mirë	Mjaft i varfër
Vlera e indexit BMWP*	204	200	134	154	96
Bioklasifikimi	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Mirë
Vlera e indexit ASPT*	8.16	7.69	5.82	6.41	5.33
Bioklasifikimi	Ujë i pastër	Ujë i pastër	Cilësi e dyshimtë	Ujë i pastër	Cilësi e dyshimtë
Indexi Biotik SWRC*	2.03	4.78	5.50	3.77	5.41
Klasifikimi i ujit	Shkëlqyeshëm	Shumë mire	I varfër	Mirë	I varfër

Bazuar në vlerat variable të indeksit të makroinvertebrate është nxjerrë edhe statuti ekologjiki i trupit ujorë Drini i Bardhë në pikat monitoruese, sikurse është prezantuar në tabelën 5.

[4] ****Sqarim mbi shkurtesat e përdorura në tabelë:*** ***ETP****-Ephemeroptera, Plecoptera, Trichoptera;* ***FBI-*** *Family Biotic Index (Indeksi Biotik i Familjeve),* ***BMWP-*** *Biological Monitoring Working Party Score (Poentimit për pjesën e punës për monitorimin biologjik);* ***ASPT-*** *Average Score per Taxon (Poentimi Mesatar per Takson);* ***SWRC-*** *Stroud Water Research Centre (Qendra Hulumtuese për Rrjedha Ujore).*

Tabela 5: Statusi ekologjik i pellgut Drini i Bardhë[5]

Lumi	Lokacioni matës	Statusi ekologjik	
Drini i Bardhë	Radavc	I lartë	
Klina - Klinë	Klinë	I moderuar	
Toplluha - Piranë	Piranë	I varfër	
Lumbardhi i Prizrenit	Vlashnje	I moderuar	
Drini i Bardhë	Vërmicë	I varfër	

Vlerësimi i cilësisë së ujit i bazuar në makrovertebrate, diatome dhe makrofite të kryera gjatë këtij projekti kanë dhënë një pasqyrë fillestare të cilësisë së ekosistemeve të ujërave të ëmbla të pellgut ujor Drini i Bardhë. Megjithatë, për të pasur rezultate të qëndrueshme dhe shkencore të cilësisë së ujit në pellgun e Drinit të Bardhë dhe më gjerë në Kosovë dhe me qëllim të krijimit të një pasqyre më të detajuar lidhur me monitorimin biologjik të ujërave sygjerohet që:

- Të përsëritet monitorimi i vlerësimit të cilësisë së ujit bazuar në makrovertebrorë, diatome dhe makrofite në stinët e tjera gjatë vitit.
- Të përsëritet monitorimi i vlerësimit të cilësisë së ujit bazuar në makrovertebrorë, diatome dhe makrofite, në më shumë stacione monitorimi të rrymës dhe lumenjve të përzgjedhur, për të pasur një pasqyrë më të saktë të cilësisë së ujit në pellgun e Drinit të Bardhë.
- Zgjerimi i monitorimit të cilësisë së ujit në rrjedhat e tjera dhe pellgut të Lumit Drini i Bardhë të cilat nuk janë përfshirë gjatë kësaj faze të monitorimit.
- Zgjerimi i monitorimit të cilësisë së ujit bazuar në indikatorët biologjikë në rrjedhat dhe lumenjtë e tjerë në Kosovë.
- Sipas kërkesave të DKU-ve, të krijohet një sistem i përsëritur në stacionet monitoruese të përzgjedhura të pellgut të Lumit Drini i Bardhë bazuar në kërkesat ligjore, së paku katër herë në vit.
- Krijimi i një baze të dhënash ku të gjitha rezultatet e monitorimit biologjik, duke përfshirë ato të paraqitura në këtë raport, mblidhen së bashku me të gjitha rezultatet e monitorimit kimik dhe vëzhgimet e tjera nga terreni.
- Meqenëse në Evropë ka shumë indikacione biotike në përdorim dhe të cilat janë të dizajnuara për zona të tjera gjeografike, është një nevojë urgjente për të standardizuar përdorimin e indekseve biotike që do të përshtateshin ashtu siç duhet për Kosovën.
- Ekziston një nevojë urgjente që të ketë një marrëveshje të mirë midis vendeve të Ballkanit për të standardizuar përdorimin e indekseve të njëjta biotike për të vlerësuar cilësinë e ekosistemeve të ujërave të ëmbla në këtë zonë.

[5] *Raporti i monitorimit biologjik në kuadër të projektit "Bashkëpunimi Ndërkufitar dhe Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në Pellgun e Zgjeruar të Lumit Drin", GWP 2017*

- Përdorimi i vendeve të referencës që posedojnë 'status të mirë ekologjik' gjithashtu mund të jenë çorientues në rajon, pasi që duhet të ketë një mënyrë të standardizuar për përcaktimin e këtyre mjediseve në ekosistemet e ujërave të ëmbla.
- Përdorimi i rekomandimeve të nxjerra nga DKU e BE-së është kuptuar ndryshe në vende të ndryshme të Ballkanit dhe ka një nevojë urgjente për të standardizuar midis vendeve metodologjinë e duhur për vlerësimin e cilësisë së ujit duke përdorur makrovertebrorë, diatome dhe makrofite.

Monitorimi i sasisë së ujërave

Përveç cilësisë së ujërave, IHMK bën edhe monitorimin e sasisë së ujërave. Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik i cili përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje për sasinë e ujit. Rrjeti hidrometrik përbëhet nga 25 stacione hidrometrike. Në këto stacione matet Niveli (h) dhe Prurja (Q). Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (m), për stacione hidrometrike përkatëse të realizuara për vitin 2017.

Tabela 6: Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse[6]

Stacioni	Mes. (m)	Max. (m)	Min. (m)
Berkovë	0.993	1.567	0.814
Brod	0.718	1.608	0.538
Caralevë	0.237	0.965	0.153
Deçan	0.310	0.779	0.224
Domorov	0.690	1.705	0.441
Drelaj	0.584	1.610	0.265
Drenas	1.154	2.275	0.880
Gjakovë	0.804	3.045	0.359
Gjonaj	1.846	4.266	1.327
Grykë	0.715	1.811	0.464
Hani Elezit	1.030	2.611	0.729
Kaçanik	0.420	1.569	0.229
Këpuz	0.995	2.495	0.505
Klinë	0.632	1.964	0.435
Konçul	2.365	4.950	1.792
Leposaviç	1.619	3.206	1.166
Lluzhan	0.856	2.855	0.482
Milloshevë	1.402	3.665	0.856
Mirushë	0.720	1.292	0.561

[6] *Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës*

Mlikë	0.602	1.239	0.302
Nedakovc	1.468	2.689	1.245
Piranë	1.075	3.455	0.809
Prizren	0.534	0.960	0.405
Viti	0.574	1.531	0.349
Vragoli	0.678	2.312	0.416

Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhënat për prurjet (Q), për katër stacione monitouese hidrometrike të realizuara për vitin 2017.

Tabela 7: Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (l/s) sipas stacioneve matëse[7]

Stacioni matës	**Mesatarja vjetore l/s**	**Minimalja vjetore l/s**	**Maksimalje vjetore l/s**
Gjonaj	45.3	6.12	97.4
Gryka e Rugovës	3.468	0.595	8.631
Gryka e Deçanit	0.516	0.252	1.230
Gryka e Prizrenit	2.603	0.577	7.014

[7] *Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës*

1.3. Toka (dheu)

Industria, bujqësia, mbeturinat, transporti, dhe ujërat e përdorura janë ndër burimet kryesore të ndotjes së tokave në Kosovë. Në shumë lokacione përreth industrive të renda, si Obiliq, Mitrovicë, Drenas dhe Han të Elezit, ndotja e tokës vlerësohet se është evidente.

Industritë e rënda bëjnë shkarkimin e ndotësve në mjedis, çka ndikon edhe në ndotjen e tokës nga prania e mbetjeve të rrezikshme qoftë të metaleve të renda apo kemikaleve.

Trendi i ndotjes dhe degradimit të tokës akoma është në rritje, përkundër shumë masave të ndërmarra nga institucionet lokale dhe qendrore. Pothuajse prej vitit 2000 e deri me sot tokat bujqësore vazhdojnë të degradohet. Kjo dukuri është më e theksuar sidomos përgjatë rrugëve kryesore lokale dhe regjionale të Kosovës.

Përdorimi i tokës

Përdorimi dhe shfrytëzimi i tokës karakterizohet më një trend të rritjes si në aspektin e shfrytëzimit për qëllime agro-ekonomike po ashtu edhe në aspektin infrastrukturorë. Shfrytëzimi i tokës bujqësore në shumë raste bëhet pa ndonjë kriter apo standard. Si pasojë e këtyre veprimeve e veçanërisht gjatë ndërtimit të infrastrukturës apo eksploatimit të materialeve inert, toka pëson degradim të pa riparueshëm.

Sipas të dhënave të Anketës së Ekonomive Bujqësore të vitit 2017, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 416 072,30 hektarë, pjesa më e madhe i përket livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) 218 314,30 ha ose (52.5 %), ndërsa tokë e punueshme – ara 186 954,16 ha ose (44.9 %).

Krahasuar me vitin 2016, gjatë vitit 2017 ka një rritje të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore, dhe po ashtu një rritje të tokave të punueshme –arave, ndërsa që ka rënie të sipërfaqeve të kullosave dhe livadheve. Tokat tjera të punueshme përfshijën kulturat shumëvjeçare me 2.3 % dhe pemishtet me 0.3%.

Ne Kosovë sektori i bimëve medicinale dhe aromatike si në kultivim ashtu edhe në grumbullim është deri diku i konsoliduar. Llogaritet diku rreth 160 ha të kultivuara si dhe 179,580 ha zona të certifikuara për grumbullim te bimëve mjekësore dhe frutave të egra.

Janë 5 kompani të certifikuara të cilat bëjnë grumbullimin e këtyre bimëve dhe 45 qendra të grumbullimit në tërë Kosovën. Eksporti bëhet si produkt gjysmë i përpunuar dhe 95% e prodhimit eksportohet jashtë Kosovës.[8]

Përgjegjësitë për menaxhimin dhe konsolidimin e tokave

Ligji për rregullimin e tokës (Nr. 04/L-040, 2012), përcakton institucionet përgjegjëse për rregullimin e tokës sikurse janë: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Komunat dhe Zyra Kadastrale te Komunave.

Ministria e Bujqësisë në harmoni me Planet Zhvillimore Komunale propozon zonat kadastrale apo pjesët e zonave kadastrale të cilat do të rregullohen me projektin e rregullimit të tokës. Agjencioni Kadastral i Kosovës zotëron të dhënat e përgjithshme për rregullim të tokës të cilat janë:

- Zonat kadastrale
- Sipërfaqja e tokave sipas kulturave
- Numri i parcelave kadastrale
- Numri i pjesëmarrësve

Mbrojtja e tokave dhe zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë varet shumë nga përgatitja dhe zbatimi i drejt i politikave të tokës. Këto politika janë çelës i kontrollit të degradimit të tokës dhe përmirësimit të shfrytëzimit të tokës bujqësore, duke u bazuar në kapacitetet e saj prodhuese.

Menaxhimi dhe administrimi i tokës në Kosovë, rregullohet me disa ligje dhe Udhëzimeve Administrative, që zbatohen nga : Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Institucioneve tjera relevante.

Përgjegjësitë për monitorimin e tokave

Në Kosovë ende nuk ka sistem të plotë dhe fuksional për monitorimin e tokave, edhe pse ekzistojnë institucionet përgjegjëse për monitorimin e tokave sikurse janë Instituti Bujqësor i Kosovës dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

[8] *Burimi: Departmenti per Politika Bujqesore dhe Tregje /MBPZHR*

Të dy këto institucione veprojnë në kuadër te ministrive përkatëse, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përkatësishtë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

Instituti Bujqësor i Kosovës ka këto përgjegjësi për monitorimin e tokave:

- Mbështetja teknike dhe shkencore për departamentet teknike të MBPZHR-së,
- Kontrolli i cilësisë së inputeve bujqësore, ushqimit dhe ruajtja e ambientit jetësor,
- Hulumtimi i varieteteve të kulturave bujqësore (grurit, elbit, misrit dhe patates) në kushtet agroekologjike të Kosovës.
- Punët hulumtuese në drejtim të krijimit të kultivarëve të grurit, hibrideve të misrit etj.,
- Punët përgatitore rreth krijimit të bankës së gjeneve për kulturat e ndryshme,
- Vlerësimi i cilësive prodhuese dhe bonitetit të tokave në Kosovë,
- Hulumtimi, identifikimi dhe inventarizimi i agjentëve të dëmshëm biologjik (dëmtuesve, patogjenëve, barojave të këqija etj.)[9]

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka këto përgjegjësi :

- Bënë monitorimin e ndotjes së tokave në tërë territorin e Kosovës, sipas programit të monitorimit;
- Bënë rishikimin e rrjetit nacional të monitorimit të cilësisë dheut dhe jepë propozimet për ndryshimet eventuale të tijë sipas nevojës.
- Monitoron cilësinë e dheut dhe kryen analizat laboratorike edhe në raste të veçanta.
- Vlerëson dhe analizon rezultatet e mbledhura nga monitorimi i cilësisë së dheut dhe harton raporte nga monitorimi i cilësisë së dheut;
- Përgatitë procedurat operative për analizat laboratorike të dheut sipas normativave evropiane për matjet laboratorike;

[9] http://www.mbpzhr-ks.net/sq/instituti-bujqesor-i-kosoves

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë në vitin 2017, është 184 të cilat përfshijnë sipërfaqe prej 126,119.29 ha ose 11.56 % e sipërfaqës së Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 19 Rezervate Strikte[10] të Natyrës ("Rezervati i Arnenit", "Maja e Ropsit", "Rusenica", "Kamilja", etj), 2 Parqe Kombëtare (PK "Sharri", PK "Bjeshkët e Nemuna"), 156 Monumente të Natyrës ("Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit", "Shpella e Gadimës", "Ujëvarat e Mirushës", "Gryka e Rugovës", "Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë", "Trungu i Rrapit në Marash" etj), 1 Park i Natyrës ("Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës"), 5 Peizazhe të Mbrojtura ("Shkugëza","Pishat e Deçanit"etj.) dhe 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve ("Ligatina e Hencit-Radevës").

Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri" Parku i Natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës", Peizazhi i Mbrojtur "Germia" dhe Monumenti i natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushë".
Gjatë vitit 2017 pas përgatitjes së arsyeshmeris profesionale nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, listës së përgjithshme të zonave të mbrojtura u janë shtuar edhe 11 Monumente të Natyrës në territorin e komunës së Ferizajt.

Tabela 8. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive 2017

Kat. e IUCN-së	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja/ha	Pjesëmarrja në ZM %
I	Rezervatet Strikte të Natyrës	19	10,885.82	**0.99**
II	Parqet Kombëtar	2	115,957	**10.6**
III	Monumentet Natyre	156	6,059.79	**0.57**
V	Park Natyre	1	5,934	**0.5**
V	Peizazh i Mbrojtur	5	2.437	**0.2**
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogive	1	109.5	**0.01**
	Totali	184	126119.29[11]	**11.56 %**

[10] Gjatë kësaj periudhe janë shpallur 8 rezervate strikte te reja ndërsa disa nga rezervatet ekzistuese u është ri definuar kufiri dhe sipërfaqja e përgjithshme.
[11] Sqarim: kjo sipërfaqe e zonave te mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna".

Gjatë vitit 2017 më iniciativën e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, janë përgatitur arsyeshmëritë profesionale për marrjen nën mbrojtje ligjore të 10 objekte (zona) të reja të natyrës, prej tyre: 9 monumente dhe 1 Peizazh i Mbrojtur në komunën e Gjakovës.

Gjatë kësaj periudhe është bërë monitorimi i zonave të mbrojtura dhe dhënia e rekomandimeve si dhe mendimet profesionale për ndërhyrjen në natyrë.
Në disa nga zonat e mbrojtura ka pasur ndërhyrje siç janë: ndërtimet ilegale, prerja e pyjeve, zjarre ne zonat e mbrojtura si dhe ndërtim të infrastrukturës.

Në 2017 ishte paraparë realizimi i projekti për shenjëzimin e zonave të mbrojtura-rezervatet strikte por për shkak të shkurtimeve buxhetore projekt pritet të realizohet në vitet në vijim.

BIODIVERSITETI

Flora dhe vegjetacioni- Kosova në saje të pozitës gjeografike dhe kushteve klimatike që ka, si dhe zhvillimin historik të florës dhe vegjetacionit, paraqet një regjion shumë të pasur me lloje, ndër të cilat një numër i madh i tyre janë endemike, relikte, si dhe lloje stenoendemike. Në kuadër të vegjetacionit përfaqësohen ekosisteme karakterisitke që paraqesin habitate edhe për shumë lloje shtazore.

Florën e vendit tonë e përbëjnë algat, likenet, kërpudhat, fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat, të cilat janë bazë e jetës dhe formojnë mbështjellësin e gjelbër të tokës që ka ndikim të drejtpërdrejt në jetën e organizmave shtazor dhe njeriut. Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet së në Kosovë janë prezent afro 2.800 - 3.000 lloje të florës vaskulare.[12]

Gjendja e tanishme e florës dhe vegjetacionit edhe pse ende nuk janë bërë analiza të plota për gjendjen e elementeve të caktuara florsitke dhe disa fitocenozave, hulumtimet e deritanishme tregojnë se florës dhe vegjetacionit të vendit tonë i kanoset rreziku nga shkatërrimi. Në këtë drejtim ka ndikuar kompleksi i faktorëve, ndër të cilët faktori antropogjen është faktori kryesor i degradimit dhe shkatërrimit të botës bimore primare dhe autoktone të këtij territori. Edhe pse ende nuk janë bërë analiza të mjaftueshme sa i përket gjendjes së elementeve të caktuara florsitke dhe disa fitocenozave, hulumtimet e deritanishme tregojnë për një gjendje jo të mirë të florës dhe vegjetacionit të vendit tonë. Në këtë drejtim ka ndikuar kompleksi i faktorëve, ndër të cilët si më kryesori është ai antropogjen që ka quar në degradimin dhe shkatërrimin e botës bimore autoktone.

[12] Libri i Kuq i flores vaskulare te Republikes të Kosovës

Gjendja e faunës - Në aspektin faunistik Kosova karakterizohet me një llojshmëri të madhe edhe pse hulumtimet në këtë drejtim nuk kanë përfunduar. Gjendja e faunës në përgjithësi është e mirë edhe atë si rezultate i zgjerimit të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, kryesisht në të dy Parqet Kombëtare që përbëjnë rreth 10% të tërë sipërfaqes së zonave të mbrojtura të natyrës. Presioni më i madh që i bëhet faunës në Kosovë ndodhë nga gjuetia ilegale që paraqitet kohë pas kohe edhe brenda hapësirave të zonave të mbrojtura.

Nga gjuetia ilegale më të rrezikuar janë kaprojtë dhe dhitë e egra. Në gjendje me të mirë janë ariu i murrmë, dhelpra, ujku etj. Për shkak të shqetësimit nga njeriu dhe mungesës së një organi menaxhues, sidomos gjatë periudhës së folenizimit, shume lloje shpendësh që dikur ishin prezente në Ligatinës e Hencit tani më shihen shumë rrallë.

Llogaritet se në Kosovë jetojnë mbi 250 lloje të kurrizorëve, ku prej tyre vetëm shpend janë 220 lloje, rreth 20 lloje reptilësh, mbi 10 lloje të amfibeve, gjithashtu mbi 30 lloje të peshqve, 176 lloje të fluturave dhe numër ende i papërcaktuar i faunës së makroinvertebrorëve të ujërave. Numri i saktë i llojeve të faunës do të përcaktohet gjatë hartimit të Librit të Kuq për faunën, i cili ka filluar në vitin 2017 dhe do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2018, ashtu edhe në kuadër të projekteve tjera.

Monitorimi i llojeve të gjitarëve - Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit në zonat e mbrojtura të natyrës, edhe gjatë vitit 2017 AMMK-ja, përkatësisht Instituti për Mbrojtjen e Natyrës, ka vazhduar monitorimin e faunës më anë të kamerave kurth në dy Parqet Kombëtare, "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna".

Vendosja e kamerave kurth është realizuar në disa pjesë të Parqeve, ku besohet se janë zona të mundshme të lëvizjes së kafshëve të egra. Gjatë kësaj periudhe janë siguruar të dhëna për praninë e llojeve të gjitarëve si: Rrëqebulli, Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Macja e egër (*Felis sylvestris*), Vjedulla (*Meles meles*), Lepuri (*Lepus europaeus*) si dhe disa lloje tjera të zakonshme. Edhe kete vit me ane te kamerave kurth eshte vertetuar prezenca e Rrëqebullit Ballkanik (*Lynx lynx ssp. balcanicus*) në territorin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Nga prania e numrit të përgjithshëm të këtyre llojeve të gjitarëve mund të konstatohet gjendja relativisht e mirë e faunës në këto dy zona të mbrojtura të natyrës.




Foto nga regjistrimet e kamerave kurthe

1.4. Mbeturinat

Gjendja në sektorin e mbeturinave - Menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Kosovë rregullohet me **Ligjin Nr. 64/L-060** për mbeturinat si dhe aktet tjera nënligjore. Komunat, zotëruesit dhe prodhuesit e mbeturinave si dhe personat e licencuar që merren me menaxhimin e mbeturinave, janë të obliguar që për çdo vit të raportojnë për menaxhimin e mbeturinave në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmet që i shkaktojnë mbeturinat kërkon zbatimin e legjislacionit të miratuar në fushën e mbeturinave ku janë caktuar standardet, teknikat dhe metodat për trajtimin e tyre të cilat ndikojnë në zvogëlimin e vëllimit të mbeturinave dhe efekteve negative në mjedis.

Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë realizohet nëpërmjet ofruesve publik dhe privat të shërbimeve, kurse mbeturinat e grumbulluara deponohen në deponitë sanitare rajonale dhe komunale.

Gjendja e deponive sanitare në Kosovë në vitin 2017 nuk është e kënaqshme. Kjo gjendje është si pasoj e shumë faktorëve, me theks të veçantë nga menaxhimi jo i mirë i deponive.

Në aspektin e përgjithshëm, mund të vlerësohet se janë shënuar hapa drejt përmirësimit në aspektin e mirëmbajtës në krahasim me vitet e kaluara. Në Deponin e Pejës dhe atë të Prishtnës gjendja është më rendë për shkak të tejmbushjes me mbeturina, mungesës së hapësirës së re për deponim si dhe problemeve me ujërat që rrjedhin jashtë deponisë. Mbulueshmëria me dheun në pjesët e mbushura me mbeturina, vlerësohet së është më e mirë në krahasim me vitet paraprake.



Mbulushmëria e mbeturinave me shtresa të dheut në deponinë sanitare në Landovicë (Prizren)

Sasia e mbeturinave të deponuara- Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të deponuara në deponitë sanitare në Kosovë është në rritje siç vërehet edhe në tabelën në vijim. Sasia më e madhe e mbeturinave është deponuar në deponinë sanitare në Mirash (Prishtinë), ndërsa sasia më e vogël në deponinë sanitare në Dragash.

Tabela 9. Sasia e mbeturinave sipas deponive sanitare 2014-2017

Deponitë Sanitare	Totali në ton 2014	Totali në ton 2015	Totali në ton 2016	Totali në ton 2017
Prishtinë (Mirash)	88,803.29	104,742.68	116,529.00	116,355.77
Prizren (Landovicë)	44,490.70	79,661.07	89,897.79	90,858.81
Mitrovicë (Gërmovë)	40,284.64	39,546.52	43,863.36	64,663.05
Pejë (Sferk)	38,950.00	44,424.00	48,342.00	47,926.00
Gjilan (Velekincë)	21,263.30	38,244.60	45,311.82	40,788.79
Ferizaj (Gërlicë)	23,462.00	13,801.23	12,904.16	21,248.18
Podujevë (Dumnicë)	7,679.20	10,315.42	10,552.70	11,083.00
Dragash (Sharr)	4,261.00	4,577.00	5,201.50	5,530.50
Totali i deponive	**269,194.13**	**335,312.52**	**372,602.33**	**398,454.10**

Rritja deponimit vërehet edhe në bazë të trendit të deponimit të mbeturinave në deponi për vitet 2014-2017 *(Fig.40).*




Figura 40. Sasia mbeturinave të deponuara 2014-2017

Nga të dhënat e raportuara për vitin 2017, në Kosovë, janë grumbulluar gjithsej 398,454.10 tonë mbeturina komunale. Të dhënat e viti 2017 tregojnë se mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë ka qenë 229 kg/banor/vit, përkatësisht 0.63 kg/banor/ditë.

Në figurat 41 është paraqitur sasia mesatare e mbeturinave komunale të grumbulluara shprehur në kg/banor/vit sipas numrit të banorëve për vitet 2014-2017[13].




Fig.41. Sasia e mbeturinave të grumbulluara në kg/banor/vit 2014-2017

Në deponit sanitare të menaxhuara nga KMDK-ja: Mirash (Prishtinë), Dumnicë (Podujevë), Velekincë (Gjilan), dhe Landovicë (Prizren), për vitet 2016-2017, deponimi i mbeturinave rezultojë te jetë më i lartë në vitin 2017 me një dallim prej 5,136.66 ton. Në vitin 2016 janë deponuar 275,195.47 ton, ndërsa në vitin 2017 janë deponuar 280,332.12 ton *(Fig.42).*




Figura 42.Trendi i deponimit të mbeturinave në deponit sanitare, te menaxhuara nga KMDK-ja për vitet 2016-2017

[13] *ASK, Vlerësimi i popullsisë së Kosovës 2014, 2015 dhe 2016.*

Në deponinë sanitare të Mitrovicës është shënuar rritje e trendit të deponimit të mbeturinave. Në këtë deponi sanitare në vitin 2017 janë deponuar 64,663.05 ton, përkatësisht 24,321.06 ton më shumë mbeturina të deponuara në krahasim me vitin 2016. Kjo arsyetohet me zgjerimin e rrjetit të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave dhe menaxhimin më të mirë të mbeturina nga operatorët përkatës.

Në vitet 2016-2017, sasia më e madhe deponimit të mbeturinave është shënuar në muajin Gusht, me 3,632.03 ton. Në këtë rritje ka ndikuar rritja e konsumit të produkteve organike. Në deponinë sanitare të Mitrovicës deponohen mbeturinat nga komunat: Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj.

Në deponinë sanitare në Pejë në vitin 2017 janë deponuar 47,926.00 ton. Trendi i deponimit nuk shënon ndonjë ndryshim të theksuar, për dallim nga viti 2016, në vitin 2017 janë regjistruar rreth 0.5 ton më pak të mbeturina të deponuara. Në këtë deponi pranohen mbeturinat nga komunat: Pejë, Deçan, Klinë dhe Istog.

Nga krahasimi i sasisë së deponuar të mbeturinave në Deponinë sanitare në Mitrovicë dhe atë në Pejë, për periudhën 2014-2017, vërehet se sasi më e madhe e mbeturinae është deponuar në deponin sanitare në Mitrovicë, me një dallim prej 5,194.2 ton.*(Fig.43*).




Figura 43. Sasia e mbeturinavë të deponuara në DS Mitrovicë dhe Pejë për vitet 2014-2017

Deponia e Dragashit dhe ajo e Podujevës janë karakteristike sepse këtu deponohen mbeturinat e gjeneruara vetëm në këto komuna. Në deponin e Dragashit në vitin 2016 janë deponuar 5,201.5 ton, kurse në vitin 2017 janë deponuar 5,530.5 ton, pra kemi një ngritje të deponimit prej 329 ton.

Në deponinë e Podujevës në vitin 2016 janë deponuar 10,315.42 ton, kurse në vitin 2017 janë deponuar 11,083.00 ton, me një dallim prej 767.58 ton. Edhe në këto deponi sasia më e madhe gjatë viteve 2016-2017 është deponuar në muajin Gusht. Nëse i krahasojmë këto dy deponi për vitin 2017, vërejmë se në deponin e Podujevës kemi një dallim prej 5,552.5 ton më shumë mbeturina të deponuara krahas asaj të Dragashit.




Figura 44. Sasia e deponuar e mbeturinave për vitin 2017- Dragash & Podujevë

Deponitë ilegale- Vlerësimi është bërë gjatë muajve maj dhe qershor të vitit 2017 nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në bashkëpunim me zyrtarët/inspektorët komunalë dhe zyrtarët e KRM-ve, me mbështetjen e GIZ-it. Nga githësjet 1,572 deponi ilegale të identifikuara, 45% janë deponi të mëdha, 36% janë deponi të mesme, ndërsa 17% janë deponi të vogla.

Në tabelën 10 janë paraqitur të dhënat në formë tabelore për numrin e deponive ilegale të identifikuara përgjatë rrugëve në 17 komuna gjatë vitit 2016, rivlerësimi i tyre në vitin 2017 si dhe numri i deponive ilegale që janë eliminuar. Pas rivlerësimit nga totali prej 1117 deponi ilegale në vitin 2016, pas eliminimit të një numri prej tyre, në vitin 2017 janë gjetur 451deponi ilegale.

Nga të dhënat e grumbulluara numri më i madh i deponive ilegale është identifikuar në komunën e Lipjanit (97), pasuar nga ajo e Drenasit dhe e Ferizajt me 57 përkatësisht 51, kure më së paku deponi ilegale janë identifikuar në komunën e Klinës (9).

Tabela 10. Krahasimi i deponive ilegale sipas komunave të identifikuara 2016 dhe 2017

Nr.	Komuna	Nr. i deponive ilegale 2016	Të eliminuara	Nr. i deponive ilegale 2017
1	Istog	82	61	21
2	Klinë	57	48	9
3	Peja	121	102	19
4	Gjakovë	70	28	42
5	Ferizaj	61	10	51
6	Kaçanik	35	17	18
7	Shtime	27	13	14
8	Drenas	137	80	57
9	Fushë-Kosovë	42	32	10
10	Graçanicë	32	16	16
11	Lipjan	105	8	97
12	Obiliq	53	42	11
13	Podujevë	35	21	14
14	Prishtinë	94	18	76
15	Mitrovicë	38	25	13
16	Skenderaj	71	53	18
17	Vushtrri	57	34	23
Gjithsej		**1117**	**666**	**451**

Mbeturinat medicinale- Ky lloj i mbeturinave trajtohet në 8 impiante, të cilat janë të vendosura në kuadër të qendrave spitalore në qendrat kryesore në Kosovë. Nga këto 8 impiante 7 prej tyre janë të ndërtuara me financimin e MMPH-s, kurse impianti në kuadër të spitalit të Vushtrrisë është i financuar nga Gjysmë Hëna e Kuqe e Emirateve të Bashkuara Arabe.

Nga të dhënat e grumbulluara nga AMMK vërejmë se kemi rritje gjithnjë të trajtimit të këtyre mbeturinave nga viti në vit (Tabela 11). Është konstatuar se jo të gjitha veprimtaritë shëndetësore i dërgojnë mbeturinat për ti trajtuar në këto impiante, për ndryshe do të kishim rritje të sasisë së këtyre mbeturinave.

Në impiantin e vendosur në QKUK në Prishtinë, është trajtuar sasia më e madhe e mbeturinave medicinale pasuar nga impianti në Prizren, kurse sasia më e vogël trajtohet në impiantin në Vushtrri.

Me përjashtim të impiantit në Gjakovë dhe në Vushtrri, të gjithë të tjerët janë duke funksionuar me kapacitet të plotë, kurse në impiantin në QKUK për shkak të sasisë së madhe të mbeturinave punohet edhe me ndërrime.

Tabela 11. Sasia e mbeturinave spitalore të trajtuara për vitet 2015-2017

Nr.	Impianti	Sasia/kg/2015	Sasia /Kg/2016	Sasia /Kg/2017
1	Prishtinë	205967	230370	246587
2	Prizren	91760	93981.8	110541.36
3	Pejë	44418	49403	49351.00
4	Ferizaj	52082	57795	8901[14]
5	Gjilan	26591	22936	36791.30
6	Gjakovë	9365	2160	2171
7	Mitrovicë	51192	66000	79359
8	Vushtrri	/	/	1647.95
8	**Gjithsej**	**481375.00**	**522645.80**	**532323.11**

Trajtimi i mbeturinave në Kosovë- Bazuar në regjistrin e azhurnuar me listën e kompanive të licencuara nga MMPH-ja që merren me menaxhimin e mbeturinave, ekzistojnë 76 kompani të licencuara të cilat kanë të regjistruara disa aktivitete si: menaxhimin e mbeturinave komunale, mbeturinat metalike, mbeturinat medicinale, mbeturinat plastike etj. Komunat me më së shumti kompani për menaxhimin e mbeturinave janë: Prishtina me 16 kompani, pasuar nga Ferizaj dhe Gjakova me 12 përkatësisht 8 kompani, kurse me vetëm 1 kompani të licencuar janë komunat Viti, Suharekë, Malishevë etj. Ne tabelën ne vijim janë paraqitur llojet e trajtimit të mbeturinave dhe numri i kompanive që merren me këto veprimtari *(Tabela 12).*

Tabela 12. Numri i kompanive që merren trajtimin e mbeturinave të ndryshme

Nr.	Lloji i mbeturinave që trajtohen	Operatorët e licencuar
1	Deponimi	1
2	Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave komunale	28
3	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i mbeturinave komunale	3
4	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i mbeturinave industriale	1
5	Trajtimi i mbeturinave mjekësore	7
6	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i mbeturinave organike	1
7	Mbledhja, transporti dhe trajtimi i mbeturinave organike, plastikës, letrës, qelqit, drurit, etj.	1
8	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i letrës dhe kartonit	2
9	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i letrës, kartonit dhe mbeturinave të plastikës.	1
10	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i mbeturinave të letrës	4
11	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i mbeturinave të metalit dhe plastikës.	2
12	Llojet e mbeturinave: akumulatorët, metalet, automjetet etj	11
13	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i mbeturinave të metalit dhe hekurit	9
14	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i mbeturinave të vajrave.	3
15	Mbledhja, transportimi dhe trajtimi i mbeturinave të gomës	2
Gjithsej		**76**

[14] *Impianti në Ferizaj ka raportuar vetëm për muajt Janar, Shkurt dhe Mars*

Anketimi për mbeturinat e trajtuara- Rezultatet e arritura nga ky anketim me bizneset të cilat merren me menaxhimin e mbeturinave për vitin 2016, tregojnë se gjithsej sasia e mbeturinave të pranuara për trajtim ka qenë 62,461 ton. Sasia e mbeturinave të dalura pas procesit të trajtimit ka qenë 55,830 ton. Sasia e mbeturinave të trajtuara në vend ka qenë 60,935 ton, kurse sasia e mbeturinave të eksportuara nga kompanitë që merren me trajtim/përpunim ka qenë 10,871 ton[15] *(Tabela 13).*

Tabela 13. Sasia e mbeturinave të menaxhuara nga kompanitë që merren me trajtim/përpunim, 2016

Lloji i mbeturinës	Sasia embeturinave të pranuara për trajtim/përpunim	Sasaisa e materialit të prodhuar	Prej të cilave	
			Trajtuara/ përpunuara	Eksportuara
Sasia në ton	ton	ton	ton	ton
Mbeturinat metalike (mbetjet metalike të hekurit, metaleve me ngjyra, hekur, bakri, kanaqe, mesingu, inoks, plumb)	41,756	33,207	40,232	4,046
Plastike (shishe të plastikës, najlon, granulat)	10,,163	12,091	11,686	498
Letër	5,322	5,312	3,860	6,128
Të tjera (mbeturinat e amvisërisë, batanije të vjetra, shishe xhami)	5,220	5,220	5,220	199
Gjithsej	**62,4261.00**	**55,830.00**	**60,998.00**	**10,871.00**

Figura 45 tregon përqindjet e materialeve të trajtuara dhe përpunuara, ku siç shihet materiali që është trajtuar dhe përpunuar më së shumti është metali me 67% dhe plastika me 16%.

[15] *ASK, Anketa e mbeturinave të trajtuara, 2016*




Figura 45. Mbeturinat e menaxhuara sipas materialit nga kompanitë që merren me trajtimin dhe përpunimin e tyre, 2016

Mbeturinat industriale- Rezultatet e Anketës së Mbeturinave Industriale (AMI) për vitin 2016, të realizuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe të prezantuara në tabelën 14, tregojnë se sasia e mbeturinave industriale ka qenë 2,335.231 ton. Këto mbeturina janë gjeneruar nga aktivitetet e realizuara në këta sektorë:

B-Xehetaria dhe guroret,
C-Prodhimi,
D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar.
E- Furnizimi me ujë, kanalizime, menaxhimi i mbeturinave dhe rivitalizimi i tokës.
F-Ndërtimtari
G-U- Sektorët e shërbimeve

Tabela 14. Gjithsej sasia e mbeturinave industriale të gjeneruara nga sektorët e industrisë B.C.D.E.F.G-U, 2016[16].

Lloji i industrisë	Gjithsej mbeturina të gjeneruara	Mbeturina të përpunuara
B.C.D.E.F.G.U	ton	ton
Gjithsej	**2,335.231**	**2,314.519**

[16] *Anketa e mbeturinave industriale 2016*

1.5. Shëndeti publik

Ndotja dhe degradimi i mjedisit është e ndërlidhur me ndikimin e aktivitetit njerëzor në sektorët e ndryshëm mjedisor dhe në burimet natyrore. Këto veprime përveç ndikimit në gjendjen e mjedisit, kanë ndikim edhe në shëndetin e njeriut dhe botës së gjallë. Ndikimet në mjedis dhe shëndet varen nga vendndodhja gjeografike, kushteve meteorologjikë, afërsia me zonave industriale e bujqësore etj.
Ndotja e mjedisit me theks të veçantë ndotja e ajrit dhe ujit vlerësohet së është një ndër indikatorët kryesore që në kontakt me organet vitale te njeriut dhe ekspozimit ndaj tyre paraqet kërcënim serioz për shëndetin.

Efektet në shëndet varen nga disa faktorë si: shkalla e ndjeshmërsë së popullsisë ndaj ekspozimit në ndotje, kohëzgjatja e ekspozimit, aftësia e përshtatshmërisë ndaj ndotjes dhe largësia nga burimi i ndotjes. Sëmundjet ambientale janë të varura kryesisht nga faktorët mjedisor, meteorologjik, socio-ekonomik, kujdesi primar dhe sekondar shëndetësorë, si dhe shkalla e informimit dhe edukimit mbi rreziqet që vijnë nga ndotja e mjedisit.

Një përmbledhje e efekteve dhe ndikimeve në shëndetin publik, ndikimeve në eksosisteme natyrore dhe ndikimeve tjera në ifrastrukturën e mjedisit dhe në trashëgiminë kulturore është prezantuar në tabelën 15.

Tab. 15. Efektet në shëndet, ekosistem dhe efektet tjera nga ndotja e mjedisit

Efektet në shëndet	**Efektet ne ekosistem**	**Efektet tjera**
✓ Reduktimin e funksionimit normal të organeve të frymëmarrjes, ✓ Irritim të syve, hundës, gojë dhe fytit, ✓ Sëmundjen e astmës dhe bronkitis, ✓ Vështirësi në frymëmarrjes, kollitje, ✓ Dobësim të organizmit, ✓ Dhimbje koke dhe marramendje, ✓ Çrregullime në sistemin e imunitetit dhe atë endokrin, ✓ Çrregullime të sjelljeve neurotike, ✓ Sëmundje kardiovaskulare, ✓ Sëmundje kanceroz, ✓ Vdekja e parakohshme, ✓ Ndikime negative në shtatzëna etj.,	✓ Ndikon në zvogëlimin e biodiversitetit, ✓ Ulë vlerën e të lashtave dhe kultura bujqësore, ✓ Ndikon në acidifikimin e ujërave të pastra, ✓ Zvogëlon cilësinë e ajrit , ✓ Ndikon në ndryshimet klimatike dhe ne shtresën e Ozonit, ✓ Rrit mundësin e katastrofave ekologjike (thatësira dhe vërshimet).	✓ Ndikon në dëmtimin serioz të objekteve të trashëgimisë kulturore. ✓ Në dëmtimin e objekteve banuese (dëmtim te materialeve)

Në këtë raport është bërë një vlerësimi i përgjithshëm i ndikimit të sektorëve mjedisor në shenëdetin publik bazuar në të dhënat relevante në dispozicion dhe janë nxjerrë rekomandime përkatëse.

Infrastruktura ligjore për sektorin e mjedisit dhe atë të shëndetit publik në Kosovë, është deri në një masë e harmonizuar me direktivat dhe standardet e Bashkimit Evropian, mirëpo kërkohen ende plotësime, mekanizma dhe instrumente për implementimin e tyre, në favor të përgjigjes efikase në nevojat dhe kërkesat për përmirësimin e mjedisit dhe shëndetit publik.
Shkarkimet e emisioneve ndotëse në ajër nga industritë e rënda, deponitë e mbeturinave, transporti, bujqësia, deponitë minerare, impiantet e vogla për djegie, ekonomitë familje, edhe në vitin 2017 ka qenë burimet kryesore të ndotjes me efekte të dëmshme në shëndetin publik.

Obiliqi, Prishtina, Fushe Kosova, Drenasi, Mitrovica, Hani i Elezit, si dhe vendbanimet afër minierave, konsiderohet si zona më të ndjeshme ku shëndeti publik është i rrezikuar nga ndotja.
Ministria e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës në nivelin nacional për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës së Republikës së Kosovës. Me qëllim të adresimit të këtij problemi Ministria është në proces të përgatitjes së projekteve të vlerësimit të ndikimit të mjedisit në shëndet.[17]

Sëmundjet ambientale - Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik të Kosovës që funksionon në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë funksionon si institucion përgjegjës për monitorimin dhe prevenimin e sëmundjeve ambientale. IKSHP bënë edhe monitorimin e gjendjes së shëndetit publik e në veçanti e bënë përcjelljen e sëmundjeve të shkaktuara nga epidemitë dhe pandemitë, lëndimet (në punë, në komunikacion, apo gjetiu), masat mbrojtëse, promovim dhe nxitja e sjelljeve të shëndosha ndaj jetës dhe mjedisit.

IKSHP, në vitin 2017, ashtu si në vitet paraprake ka përcjellur, monitoruar dhe regjistruar numrin dhe trendin e sëmundjeve ambientale të shfaqura tek popullata.

Gjatë vitit 2017, disa sëmundje raportohen me numër me të lartë ndërsa disa të tjera me rënie. Sikur vërehet edhe nga tabela 16, sëmundjet si ITPR-Pneumonia/ARI, SARI (formë e rënd e pneumonisë) dhe influenca sezonale, kanë shënuar rënie të numrit të të sëmuarve në krahasim me vitin 2016. Për disa sëmundje tjera si diarreja akute, sallmonelosis dhe disa sëmundje ngjitëse është regjistruar ngritje e numrit të të sëmuarve krahasuar me vitin 2016.

[17] *Strategjia Sektoria e Shëndetësisë 2017-2021, Ministria e Shëndetësisë 2016*

Tab. 16. Trendet e sëmundjeve ambientale për vitet 2014-2017

Sëmundjet	2014		2015		2016		2017	
	Rastet	Mbi 100000 banor	Rastet	Mbi 100000 banor	Raste	Mbi 100000 banor	Raste	Mbi 100000 banor
ITPR-Pneumonia/ARI	15242	839.4	12133	664	13897	760.5	13608	744.7
SARI (Formë e rënd e pneumonisë)	521	28.7	66	3.6	217	11.8	117	6,4
Influenca sezonale	39758	2189.7	41798	2287.5	84697	4635.2	51504	2818,7
Diarreja akute	66196	3635.8	60361	3303.4	76386	4180.4	91312	4997,2
Varicela	8651	476.4	7172	392.5	8075	441.9	8152	446,1
Sindromi i diarresë me gjak	38	2.1	22	1.2	29	1.5	35	1,9
Sindroni meningjeal	188	10.3	250	13.6	152	8.3	149	8,1
EHKK	5	0.2	1	0.05	1	0.05	0	0
EHSV	14	0.7	2	0.1	4	0.2	6	0,3
Ëest Nile virus	4	0.2	2	0.1	0	0	2	0,1
Sëmundja e lajmit	14	0.7	3	0.1	4	0.2	2	0,1
Leishmaniasis	3	0.1	0	0	2	0.1	0	0
Malaria	-	-	4	0.2	1	0.05	0	0
Sindrome me ethe ekzantematike	21	1.1	23	1.2	14	0.9	1	0,05
Pertussis	16	0.8	39	2.1	24	1.3	32	1,7
Parotiti epidemik	3743	206.1	1900	103.9	184	10.06	120	6,5
TBC	834	45.9	770	42.1	-	-	-	-
Intoxicatio alimentaris	684	37.6	1202	65.7	2132	116.6	2278	124,6
Verdhëza akute A	154	8.5	124	6.7	124	6.7	115	6,3
Verdhëza B	52	2.8	63	3.4	59	3.2	83	4,5
Verdhëza C	14	0.7	12	0.6	21	1.1	3	0,1
Verdhëza toxice	0	0	2	0.1	3	0.1		
Typhus abdominalis	6	0.3	3	0.1	11	0.6	2	01
Sallmonelosis	53	2.9	81	4.4	66	3.6	109	5,9
Rota virus	117	6.4	75	4.1	156	8.5		
Tularemia	105	5.8	378	20.6	27	1.4		
Lymphadenitis	92	5.1	192	10.5	106	5.8		

Leptospirosis	6	0.3	3	0.1	3	0.1		
Bruceloza	34	1.8	31	1.6	26	1.4	32	1,7
Anthrax	6	0.3	-	-	-	-	-	-
Tetanosis	0	0	2	0.1	1	0.05	0	0
Echinoccocosis	0	0	4	0.2	-	-	1	0,5
Toxoplasmosis	0	0	14	0.7	10	0.5		
Vulnus morsum viperi	9	0.5	13	0.7	45	2.4	31	1,7
Vulnus morsumcani	-	-	-	-	1	0.05	0	0
Campylobacter							1	0.05
Sëmundjet tjera ngjitëse	752	33.8	592	32.3	539	29.4	656	35,9
Total	137591	7578.2	127449	7374.5	187435	10257.8	169997	9303,5

Sëmundjet ambientale paraqiten si pasoje e higjienës së dobët, kushteve socio-ekonomike, furnizimit me ujë të pijes nga burimet e pakontrolluara-puset, ndërprerja e gjatë e ujit nga ujesejllesi, ujërat e ndotura, mungesa e kanalizimit, hedhja e mbeturinave afër burimeve të ujit dhe ndotës tjerë.

Probabiliteti për shfaqjen e shumë sëmundjeve është më i madh gjatë stinës së verës, për shkak se në këtë periudhë kohore temperaturat janë më të larta, duke krijuar kushte më të favorshme për përhapjen e viruseve dhe bakterieve. Në të njëjëtën periudhë kohore, kushtet higjeno sanitare në disa vise të Kosovës janë në nivel më të ulët si rezultat e mungesës së ujit dhe thatësisë.

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike, në raport me një sërë standardesh kundër të cilave mund të vlerësohet pajtueshmëria. Cilësia e ujit të pijshëm, është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Kosova ka një legjislacion adekuat e cila është prezantuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, dhe i cili është në përputhje me standardet e BE- së, për ujin e pijshëm.

KRU kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësor për konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Nga ana tjetër IKSHPK, është Institucion me përgjegjësinë ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin e ujrave të pijshëm, i cili siguron se uji i distribuuar nga KRU është në përputhje me vlerat parametrike të standardeve vendore të cilësis së ujit. Në këtë raport vlerësimi i cilësisë është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga QU në ARRU.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të kryer nga Qendra e Ujit e Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHPK) konform përgjegjësive që ka kjo Qendër për monitorim të jashtëm sipas UA Nr. 16/2012, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve ne 44 zona te furnizimit (ZFU) të shtrira në zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve, është 99.54% në përputhshmëri me vlerat parametrike mikrobiologjike, ndërkaq 98.30% në përputhshmëri me vlerat parametrike kimike, duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë prej 98.58%.

Kjo shkallë e përputhshmërisë është rezultat i 59,604 testeve të kryera gjatë vitit 2017 nga gjashtë laboratorët rajonalë të Qendrave Rajonale të Shëndetësisë Publike (QRSHP) dhe Qendra e Laboratorëve Testues në IKSHPK. Siç mund të shihet nga figuren 46, përputhshmëria më e lartë sa i përket vlerave të parametrave mikrobiologjikë ka qenë në KRU Radoniqi dhe KRU Mitrovica 100%, ndërkaq përputhshmëria më e ulët në KRU Hidromorava 97,1%.

Përputhshmëria më e lartë sa i përket parametrave kimik ka qenë në KRU Radoniqi me 100% përputhshmëri dhe KRU Mitrovica me 99.8%, ndërkaq KRU Bifurkacioni me 96.9%, KRU Prishtina me 97.7% dhe KRU Hidrodrini me 97.8% rezultojnë me përputhshmërinë më të ulët.




Fig. 46. Kualiteti i ujit sipas KRU-ve për vitin 2017[18]

Një pasqyrë e përmbledhur e rezultateve të monitorimit sipas zonave të furnizimit është dhënë në tabelën vijuese.

[18] *Cilësia e ujit të pijshëm në Kosovë, 2017, Rapport IKSHP*

Tabela 17: Cilësia e ujit të pijshëm sipas parametrave bazik ne zonat e furnizimit per vitin 2017[19]

Parametrat	**Numri i testeve të kryera**	**Përputhshmëria me vlerat parametrike**	**Tejkalimi i vlerave parametrike**	
		%	Nr.	Nr. i ZFU-ve
Koliformet totale	6,032	99.29	43	11
E coli	6,032	99.8	12	7
Klori rezidual	5,991	89.65	620	30
Turbullira	6,035	99.27	44	11
Era	2,357	100	0	0.0
Shija	2,357	100	0	0.0
pH	2,357	99.96	1	1
Nitratet	2,350	99.74	6	3
Nitritet	2,357	99.92	2	2
Hekuri	2,327	99.83	4	3
Mangan	2,399	99.71	7	4
Alumini	1,079	99.81	2	2
Parametrat tjerë	17,932	99.4	108	16
Totali:	**59,604**	**98.58**	**849**	**90**

Krahasuar me vitin 2016, cilësia e ujit të pijshëm në vitin 2017 ka shënuar një përmirësim të lehtë prej 0.3% në total. Në përgjithësi, shkalla e përputhmërisë sa i përket parametrave mikrobiologjikë dhe atyre kimik është përmirësuar nga 98.3% në 98.53%.

Shkalla më e ulët sa i takon përputhshmërisë me vlerat parametrike ka të bëj me klorin rezidual (89.6%). Kjo situatë është prezente në vazhdimësi në të gjitha KRU-të dhe reflektohet ne pasqyrën e përgjithshme të përputhshmërisë. Kjo indikon një problem operativ të cilin KRU-të duhet ta adresojnë në formën e duhur me klorinim të rregulltë dhe adekuat të ujit të cilin e furnizojnë si dhe me kontrollin operacional te metodologjisë të klorinimit. Parametrat tjerë kanë qenë përgjithësisht në nivel të kënaqshëm - mbi 99%.

[19] Po aty

Mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujësjellës gjatë vitit 2017 në nivel sektori arrin shkallën prej 94%, e që është për 3% më e lartë se sa në vitin paraprak 2016. KRU Prishtina, Gjakova dhe Hidrodrini , kanë arritur mbulueshmëri të lartë të popullatës me shërbime në kuadër të zonave të tyre respektive të shërbimeve. Mbulueshmëria e ultë me shërbimet e ujësjellësit gjatë vitit 2017 vazhdon të jetë në KRU Hidroregjioni Jugor me 70%, Hidromorava me 75% si dhe Mitrovica me 76%.[20]

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura-kanalizim në nivel sektori gjatë vitit 2017, arrin në nivelin prej 74%. Shkallën më të lartë të mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura gjatë vitit 2017 e ka arritur KRU Prishtina, sikurse te mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit, vlen të theksohet së ndikim ka pas fluksi i madh i lëvizjes së banorëve nga qytetet tjera dhe regjistrimi i tyre si ekonomi apo konsumatorë të kësaj kompanie. Nivel të ulët të mbulueshmërisë me shërbimin e ujërave të ndotura vazhdon të jetë në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini me 44%, kjo është për 5% më shumë se në vitin paraprak 2016.[21]

[20] *Raporti vjetror i përformancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë, 2017, ARRU*
[21] Po aty

2. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit

2.1. Përafrimi i legjislacionit mjedisor me Direktivat e BE-së

Politika e përgjithshme Kombëtare e Kosovës përfshinë edhe procesin e integrimeve evropiane. Ndër sfidat kryesore në këtë proces është edhe mjedisi, plotësimi i standardeve mjedisore evropiane dhe përafrimi i legjislaturës kombëtare mjedisore me atë evropiane.
Në tabelën 18 është prezantuar një përmbledhje e direktivave kryesore të BE-së për mjedisit dhe niveli i transpozimit të tyre në legjislacionin nacional mjedisor.

Tabela 18: Transpozimi i direktivave të BE në legjislacionit nacional mjedisor

Fusha	**Direktiva e BE**	**Niveli i trans pozimit[22]**
Legjislacioni horizontal	Direktiva për VNM (85/337/EEC)	91%
	Direktiva për VSM (2001/42/EC)	100%
	Direktiva për informimin mjedisor (2003/4/EC)	66%
	Direktiva për pjesëmarrjen e publikut (2003/35/EC)	100%
	Direktiva INSPIRE (2007/2/EC)	20%
	Direktiva për Krimin Mjedisor (2008/99/EC)	50%
	Direktiva për përgjegjësinë ndaj mjedisit (2004/35/EC)	84%
Kualiteti i Ajrit	Direktiva për kualitetin e ajrit ne ambient (2008/50/EC)	92%
	Direktiva për Arsenin, Kadmiumin, Merkurin, Nikelin, dhe hidrokarburet aromatike poli ciklikë në ajër (2004/107/EC 4th Daughter Directive)	98%
	Direktiva NEC, Pragjet e emisioneve nacionale ne ajër (2001/81/EC NEC Directive	12%
	Direktiva për përmbajtjen e sulfurit të derivate te lëngshme (1999/32/EC Sulphur Cont. Liquid Fuels)	60%
	Direktiva për pikat e karburatëve VOC- Substancat Organike Volatine (94/63/EC VOCs Petrol)	98%
	Direktiva për fazën II për pikat e karburantëve VOC- Substancat Organike Volatine (2009/126/EU Stage II VOCs petrol)	30%
Menaxhimi i mbeturinave	Direktiva kornizë për mbeturina (2008/98/EC)	81%
	Direktiva për bateritë mbeturine (2006/66/EC)	61%
	Direktiva për ambalazhet mbeturinë (94/62/EC)	100%
	Diretkiva per PCB/PCT- Poliklorur Bifenili dhe Poliklorur Trifenili (96/59/EC PCB/PCT)	87%

[22] *Monitoring transposition and implementation of the EU environmental acquis, Year 18 , Progress Report- Kosovo , ECRAN*

	Direktiva për automjetet mbeturina (2000/53/EC End-of-Life Vehicles)	100%
	Direktiva për deponit (99/31/EC / Landfill)	100%
	Direktiva për kufizimin e përdorimit te disa substancave te rrezikshme ne pajisjet elektrike dhe elektronike (2011/65/EU RoHS)	92%
	Direktiva për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (2012/19/EU ËEEE)	86%
	Direktiva për menaxhimin e mbetjeve minerare (2006/21/EC Mining Ëaste)	100%
	Direktiva per llumin e ujërave të zeza (86/278/EEC Seëage Sludge)	100%
Kimikatet	Direktiva për Asbestin (87/217/EEC)	82%
Kualiteti i ujit	Direktiva kornizë për ujërat (2000/60/EC)	57%
	Direktiva për ujërat e ndotura urbane (91/271/EEC) UËËT	51%
	Direktiva për ujërat nëntokësorë (2006/118/EC Groundëater)	32%
	Direktiva për ujin e pijes (98/83/EC)	100%
	Direktiva për nitratet (91/676/EEC)	26%
	Direktiva për ujërat larëse (2006/7/EC Bathing Ëater)	0%
	Direktiva për standardet e kualitetit të ujit (2008/105/EC)	5%
	Direktiva për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga vërshime (2007/60/EC Floods)	4%
	Direktiva për specifikacionin teknik për analiza kimike te monitorimit te statusit të ujërave (2009/90/EC Quality Assurance/Quality Control)	0%
Mbrojtja e Natyrës	Direktiva për zogjtë e egër (79/409/EEC)	100%
	Direktiva për habitatet (92/43/EC)	100%
	Direktiva për rregullat e mbajtjes së shtazëve të egra në kopshte zoologjike (1999/22/EC Zoos)	80%
Kontrolli i ndotjes industriale	Direktiva për emisionet industriale (2010/75/EU)	68%
	Direktiva Seveso III për Kontrollin e aksidenteve te mëdha industriale (2012/18/EU)	27%
	Direktiva për Kontrollin e materieve VOC (2004/42/EC -VOCs from Paints, Varnishes and Vehicle Refinishing Products)	25%
Zhurma	Direktiva për zhurmën mjedisore (2002/49/EC)	74%

2.2. Niveli i Zbatimit të Strategjive dhe Planeve Mjedisore

Kosova e ka në masë të kënaqshme të zhvilluar kornizën strategjike dhe programore për mjedisin dhe sektorët e tij, mirëpo niveli i zbatimit është ende në shkallë të ulët. Në tabelën 19, janë prezantuar dokumentet kryesore strategjike dhe programore të sektorit të mjedisit dhe niveli i zbatimit të tyre.

Tabela 19: Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit

Strategjia/Plani	Periudha e vlefshmërisë	Statusi i dokumentit	Niveli i zbatimit
Strategjia Mjedisore e Kosovës dhe Plani Kombëtar i Veprimit Mjedisorë	2013-2022	Nuk ka vendim mbi aprovimin nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga Kuvendit i Kosovës	Nuk ka filluar së zbaturi për shkak të paqartësisë në procesin e aporvimit
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet	2011-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Në proces të rishikimit)	Pjesërisht
Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022	2013-2022	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit	2018-2020	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Në fazën fillestre të zbatimit
Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2013-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Në proces të rishikimit)	Pjesërisht
Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	2013-2017	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Në proces të rishikimit)	Pjesërisht
Strategjia dhe Plani Veprimit për Ndryshimet Klimatike për Kosovën	2017-2026	Ne procedure të aprovimit në Qeverinë e Republikës së Kosoves	Nuk ka filluar ende
Strategjia Shtetërore e Ujërave	2017-2022	Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2018	Zbatimi në fazën fillestare
Plani Hapësinor i Kosovës-Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës	2010-2020+	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht - Në proces të implementimit harta zonale e Kosovës
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”	2013-2022	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht – në proces të hartimit edhe dy plane rregulluese
Plani Hapësinore për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Nuk ka filluar zbatimi në mungesë të organit

Mirushës”			menaxhues për këtë zonë të mbrojtur
Plani Hapësinorë për Zonën e mbrojtur me Interes të veçantë “Beteja e Koshares”	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani Hapësinorë për Zonën e me Interes të veçantë “Shtabi i përgjithshëm i UÇK-se, Kleçkë dhe Divjakë”	2014-2023	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani Hapësinorë për Zonën e me Interes të veçantë “Fusha e Mihjes së re”	2010-2020	Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës	Pjesërisht
Plani Menaxhues për Parkun Kombëtar “Sharri”	2015-2024	Aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Pjesërisht

2.3. Zhvillimet dhe ngecjet institucionale

Ndër zhvillimet kryesore në forcimin, afirmimin dhe ngritjen e kapaciteteve teknike të institucioneve mjedisore duhen veçuar:

- Themelimin e Autoritetit Rejonal të Pellgjeve Lumore;
- Emërimi i Koordinatorit Nacional për Ndryshime Klimatike;
- Themelimi i Task Forëcës ndërministrore për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Themelimi i komitetit drejtues për Sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave;
- Rritja e numrit të personave fizik të licencuar për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
- Fillimi i procesit për akreditimin e laboratorit dhe stafit të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës;
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve mjedisore përmes trajnimeve dhe programeve në nivelin nacional, regjional dhe ndërkombëtarë;
- Rritja e përfaqësimit të institucioneve mjedisore të Kosovës në organizata, iniciativa dhe projekte rajonale.

Ndërsa, në kuadër të ngecjeve dhe pengesave në forcimin e institucioneve mjedisore gjatë kësaj periudhe veçohen:

- Mungesa e rrjetit për monitorimi e ujerave nëntokësore;
- Mungesa e monitorimit te aspekteve biologjike/ekologjike të ujërave sipërfaqësore;
- Numri i vogël i zyrtarëve në sektorin e monitorimit të ajrit;
- Mungesa e një sektori të veçantë për Ndryshime Klimatike në MMPH;
- Mungesa e një institucioni të veçantë në nivel qendror për monitorimin e kimikateve;
- Numri i vogël i programeve edukative të nivelit bachellor dhe master në fushën e mjedisit;
- Numri i vogël i stafit në sektorin e natyrës e sidomos ne Institutin e Mbrojtjes se Natyrës;
- Mos funksionalizimi i Bordit Këshilldhënës për Mjedisin;
- Largimi i stafit të trajnuar dhe më përvojë nga institucionet përgjegjëse të sektorit të mjedisit.
- Kapacitetet e limituara të komunave në sektorin e mjedisit;
- Buxheti i limituar në sektorin e mjedisit.

2.4. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të ligjit

Në kuadër të kompentenave të kontrollit nga ana e Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave, Natyrës, dhe Planifikimit hapësinorë dhe Ndërtimit sipas detyres zyrtare, MMPH- së gjatë vitit 2017 janë realizuar: 481 aktivitete mbikqyrëse në fushën e mjedisit; 310 aktivitete mbiqkyrëse me procesverbal në fushën e ujërave; 15 akitivitete mbikqyrëse me procesverval në fushën e natyrës; dhe 180 aktivitete mbikqyrëse me procesverbal në fushën e planifikimit hapësinorë dhe ndërtimeve. Detajet tjera janë prezantuar në tabelën 20.

Tabela 20: Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore

Lloji i aktivitetetit inspektuese në fushën e mjedisit	Numri i aktiviteteve
Vendime	3
Denime Mandatore	-
Rekomandime, vërejtje dhe urdhëresa	389
Inicim të procedurave gjyësore	95
Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e ujërave	Numri i aktiviteteve
Vendime	2
Inicime për procedura kundërvajtëse në gjykata	55
Rekomandime, vërejtje, urdhëresa dhe informata	268
Lloji i aktivitetetit inspektuese në fushën e natyrës	Numri i aktiviteteve
Inicime për procedura kundërvajtëse në gjykata	2
Rekomandime, vërejtje, urdhëresa dhe informata	12
Lloji i aktivitetetit inspektues në fushën e planifikimit hapësinorë dhe ndërtimit	Numri i aktiviteteve
Inspektime me procesverbal	180
Vendime	22
Inicime për procedura gjyqësore	2
Rekomandime, vërejtje dhe urdhëresa	12

Ndërsa në sektorin e mbrojtjes së natyrës në kuadër të kërkesave për fillimin të procedurave kundërvajtës të bazuar në Ligjin e Natyrës dhe Ligjit për Parqe Kombëtare, dhe legjislacionin relevant, gjatë vitit 2017 AMMK, në emër të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë Bjeshkët e Nemuna dhe Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë Sharri, ka parashtruar: 229

Kallëzime penale; 15 Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse; dhe 43 Kërkesa për inicimin e propozim padive për kontest civil.

Përmes inicimit të këtyre 357 procedurave pretendohet realizimi i dëmit në vlerë totale prej 519,484. 70 € për institucionin të shkaktuar përmes veprave të kundërligjshme nga persona të pandërgjegjëshëm (tabela 21).

Tabelat 21: Inicimet e AMMK në Gjykata, Prokurori, dhe Avokaturë Shtetërore

Lloji i aktivitetetit në emër të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë Bjeshkët e Nemuna	Numri i lëndëve	Shuma e dëmit
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Pejë	122	318,450.70 €
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Gjakovë	3	2,700.00€
Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Pejë – Divizioni për Kundërvajtje	3	3,067.00 €

Lloji i aktivitetetit në emër të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë Sharri	Numri i lëndëve	Shuma e dëmit
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Ferizaj	79	56,500.00 €
Kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Prizren	25	64,199.00 €
Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Degën e Gjykatës në Suharekë – Divizioni për Kundërvajtje	4	8,666.00 €
Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Degën e Gjykatës në Dragash – Divizioni për Kundërvajtje	5	1,904.00 €
Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Degën e Gjykatës në Kaçanik – Divizioni për Kundërvajtje	2	858.00 €
Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Prizren – Divizioni për Kundërvajtje	1	1,270.00 €
Lloji i aktivitetetit në emër të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë Sharri dhe Bjeshkët e Nemuna	Numri i lëndëve	Shuma e dëmit
Kërkesa për inicimin e kontesteve civile të dorëzuara në Avokaturën Shtetërore – Ministria e Drejtësisë	43	62,355.00 €

2.5. Leje dhënia

Sipas të dhënave nga MMPH, gjatë vitit 2017 janë realizuar aktivitete në të gjitha fushat përkatëse. Bazuar në autorizimet e legjislacionin mjedisor, janë lëshuar 147 leje në fushën e mjedisit, 5 leje në fushën e natyrës, 102 licenca dhe leje në fushën e mbeturinave, dhe 44 Akte tjera në fushën e ujërave.

Të dhëna më të detajuara për aktivitetet e lejedhënies në sektorin e mjedisit, mbeturinave, natyrës, dhe të ujërave janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 22: Aktivitetet për Leje dhënive gjatë vitit 2017

Aktivitetet për Pëlqime Mjedisore	
Lëndë të pranuara për Pëlqime Mjedisore	180
Të lejuara	120
Lëndë të refuzuara	20
Në procedurë të shqyrtimit	20
Aktivitetet për Leje Mjedisore	
Lëndë të pranuara për Leje Mjedisore	61
Të lejuara	49
Lëndë të refuzuara	12
Konkluzione	1
Aktivitetet për Leje të Integruara Mjedisore	
Të lejuara	5
Aktivitetet e Leje dhënieve në fushën e natyrës	
Leje për hulumtime shkencore në natyrë	3
Leje për preparimin e ekzemplarëve të ngordhur të arinjëve (Ursus Arctos) në bazë të U.A Nr. 26/2012	1
Leje për lejimin e ndërmarrjes së veprimeve me llojet të bimëve të egra strike të mbrojtura	1
Aktivitetet e leje dhënieve në fushën e mbeturinave	
Licenca për menaxhimin e mbeturinave	21
Leje për import të kemikateve	3
Leje për produkte biocide	29
Leje për import për qese plastike pa aditiv	28
Leje për eksport të mbeturinave	21
Aktivitetet për Leje dhënieve në fushën e ujërave	
Kushte Ujore	19
Pëlqime Ujore	13
Leje Ujore	4
Vazhdime të Lejeve Ujore	8
Vendime për refuzim të Lejes Ujore	15
Ndryshim të Vendimeve	1
Konkluzione	16

2.6. Investimet në mjedis

Investimi në mjedis është një prej formave direkte të intervenimit për mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe parandalimin e ndikimeve negative në mjedis. Qeveria e Kosovës, pjesën më të madhe të investimeve në mjedis e ka orientuar përmes buxhetit për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Por gjithashtu edhe komunat dhe institucionet tjera, një pjesë të buxhetit e orientojnë në projekte mjedisore.

Duke analizuar buxhetin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë për periudhën 2015-2018, vërejmë se ka pasur një ngritje të ndjeshme si për totalin e buxhetit ashtu edhe për investimet kapitale në mjedis.

Derisa investimet kapitale në mjedis në vitin 2015 ishin mbi 34.9 milion euro, në vitin 2016 ato janë rritur në rreth 36 milion euro, në vitin 2017 në 49 milion euro, ndërsa në vitin 2018 në rreth 53 milion euro (tabela 23).

Tabela 23: Buxheti total dhe buxheti për shpenzime kapitale i MMPH 2015-2018[23]

	2015	2016	2017	2018
Shpenzime kapitale	34,901,813	35,903,684	45,824,312	49,187.682
Buxheti Total	38,043,185	39,357,027	49,121,434	52,893,885

Shpenzimet kapitale të MMPH, gjatë vitit 2017 kanë qenë kryesisht projekte që janë implementuar për rregullimin e shtretërve të lumënjëve, menaxhimin e mbeturinave, zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit si dhe projekte tjera mjedisore në interes të përgjithshëm. Në tabelën vijuese janë prezantuar disa nga këto projekte të implementuara nga MMPH.

Tabela 24: Projekte mjedisore të implemetuara nga buxheti i MMPH gjatë vitit 2017

Emri i Projektit	Shuma e Buxhetit 2017 €
Pastrimi i Lumit Lepenc nga mbeturinat e Azbestit	93.000
Inventarizimi i llojeve të bimëve, shtazë, tipave të vendbanimeve natyrore dhe paraqitja hartografike e tyre	20.000
Ndërtimi i deponisë komunale në regjionin e Pejës	10.000
Ndërtimi i deponisë së materialeve të ngurta në Prishtinë	50.000

[23] *Ministria e Financave www.mf.rks-gov.net*

Ndërtimi i Kopshtit Botanik	20.000
Zhvillimi i bazës së të dhënave në nivelin qëndror për mjedis, inspektorat dhe ujëra	50.000
Ndërtimi i kanalizimit në Deçan	160.000
Rregullimi i shtratit të lumit Krena - Gjakovë	400.000
Akumulacioni i uji në lumin Ibër - Mitrovicë	1.350.000
Sistemimi i ujërave të zeza dhe projekti i përmisimit infrastruktural në lumin Bistrica në Prizren	1.800.000
Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc në Kacanikut	190.000
Rregullimi i shtratit të lumit Drenica në Drenas	300.000
Rehabilitimi i ujësjellsit dhe rritja e kapacitetit të ujit për 9 fshatrat e Kaçanikut	500.000
Projektet e ujësjellësit në Drenas	129.187
Rregullimi i kanalit të ujitjes Dubovë-Dobrushë-Kashicë-Saradran,Istog	55.000
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Runik – Skënderaj	200.000
Rregullimi i shtratit të lumit Bistrica - Pejë	200.000
Fabrika e Ujërave të zeza në Pejë	3.800.000
Hapja dhe pastrimi i shtratit të Lumit Sitnica	350.000
Kanalizimi në fshatin Raushiq, Pejë	100.000
Rehabilitimi i shtratit të lumit Klina - Klinë	210.000
Rregullimi i shtratit të lumit Rahovec	10.000
Rregullimi i kanalizimit Kamenicë	10.000
Rregullimi i kanalizimit në Mitrovicë	10.000
Rregullimi i kanalizimit në Skënderaj	10.000
Rrjeti i kanalizimit në fshatin Tvrdjen, Leposavic – Faza e dytë	50.000
Ujësjellësi Roganë-Muqivërcë-Novosellë-Hodonov në Kamenicë	295.000
Ujësjellësi Kopëmicë –Kolloleq-Shipashnicë në Kamenicë	83.000
Ujësjellësi Koretin – Kamenicë	43.000
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat e Kacanikut	561.177
Rrjeti i kanalizimit në Prekaz-Mikushnicë, Skënderaj	500.000
Ujësjellësi Shipol-Brus, Mitrovicë	400.000
Ujësjellësi Vushtri-Gracë	485.594
Ujësjellësi për 10 fshatrat dhe kyçja në burimet e reja, Decan	50.000
Ujësjellësi në Gadime, Lipjan	20.000
Mirëmbajtja e rrjetit të stacioneve të monitorimit të ajrit	150.000
Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës	10.000
Mirëmbajtja e stacioneve hidrometrike të Kosovës sipas pellgjeve	20.000
Avancimi i rrjetit ekzistues meteorologjik dhe automatizimi i tij	40.000
Fuqizimi i menaxhimit të Parqeve Kombëtare :Mali Sharr dhe Bjeshkët e Nemuna	60.000

Mbështetja nga donatorët gjatë vitit 2017 ka vazhduar me disa projekte që kanë qenë vazhdimësi e projekteve nga vitet paraprake dhe me projekte të reja. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për disa nga projektet më të mëdha të mbështetetura nga donatorët për sektorin e ujërave dhe mjedisit.

Tabela 25: Disa nga projektet me donatorë në sektorin e mjedisi dhe ujërave 2017

Emri i projektit	Organizata përkrahëse-donatori	Vlera e projektit	Periudha e impmenetimit
Mbështetje të Zbatimit në Paketën e energjisë me fokus në Efiçiencë të Energjisë dhe Energjisë së ripërteritshme.	BE & GFA	2,274,190.00 €	2016 – 2019
ORF Biodiversity (Open Regional Found for Biodiversity) Projekt i përbashkët për Kosove, Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Mal i zi dhe Bosnje e Hercegovine.	GIZ	3,000,000.00 €	2015 - 2018
Projekti "Mbështetje Programit Mjedisor MMPH-së Kosovë "	SIDA	6,810,000.00 €	2016 – 2020
Projekti "Mbi menaxhimin e integruar të burimeve ujore të pellgut të zgjeruar të Drinit"	UNDP/GEF	1,000,000,00 $	2016 – 2019
Projekti për ndërtimin e sistemit lagunar për trajtimin e ujërave të zeza në Kramovik	UNDP/GEF	200,000.00 €	2016 – 2019
Projekti Regjional për vërshime "IPA FLOODS"	BE&CIMA	1,998,386.00 €	2015 - 2017
Projekti "Gara për mjedis të pastër "	KFW&GIZ	3,400,000.00 €	2015 –2017
Projekti "Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit"	JICA	4.000.000,00 $	2017 – 2020
Mbledhja e të dhenave mjedisore (Programi Threshold MCC)	MCC -USA	3.000.000,00 $	2017-2019
Investimi në energji eficente në sektorin e amvisërisë (Programi Threshold MCC)	MCC -USA	20.700.000,00 $	2017-2019
Investim në sistemin e ngrohejs qëndrore (Programi Threshold MCC)	MCC -USA	10.900.000,00 $	2017-2019

3. Te gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Të gjeturat kryesore të raportit

Ajri

- ✓ Përkundër progresit të arritur në ngritjen e rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit, ende ka nevojë që të investohet në modernizimin, plotësimin dhe mirëmbajtjen e këtij rrjeti dhe në veçanti për funksionalizimin e softuerit qendror për përpunimin e të dhënave dhe raportin e tyre në kohë reale.
- ✓ Të dhënat nga monitorimi flasim për tejkalime të vlerave maksimale të lejuara, për disa parametra e në veçanti për PM10 dhe PM2.5, dhe kjo kryesisht gjatë sezonës së dimrit.
- ✓ Vlerësimet tregojnë që burimet kryesore të ndotjes janë sektori i energjisë, transportit dhe ai i amvisërisë. Megjithëkëtë nevojitet të bëhet një inventar i plotë i emetimeve në ajër dhe po ashtu një studim më i detajuar për shpërndarjen dhe koncentrimin e ndotësve.
- ✓ Është konstatuar po ashtu implementimi në nivel të ulët i ligjeve, akteve nënligjore dhe i politikave për sektorin e ajrit sikurse është rasti i politikave për kontrollin e emisionet nga burimet e lëvizshme dhe atyre për kontrollin e cilësisë së naftës.
- ✓ Nivel i ulët i zbatimit kërkesave ligjore edhe në nivelin lokal. Edhe pse Ligji për cilësinë e ajrit kërkon hartimin e Planeve Lokale të Veprimit për cilësi të ajrit, deri me tani asnjë komunë në Kosovë nuk e ka të hartuar dhe të aprovuar një dokument të tillë.

Uji

- ✓ Cilësia e ujërave sipërfaqësore në Kosovë, vazhdon të jetë e ndikuar nga ndotja që vije si rezultat i shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale, hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave në lumenj, përdorimit të pesticideve dhe fertilizerëve në bujqësi si dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i inerteve dhe ndërtimet ilegale.
- ✓ Aktualisht monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore kryhet në 54 pika monitoruese në lumenj, ndërsa monitorimi i sasisë së ujërave kryhet në 26 stacione monitoruese. Ende nuk ka monitorim të rregullt të cilësisë së ujërave të liqeneve, dhe ujërave nëntokësore, sikurse që nuk ka as monitorim biologjik të ujërave sipërfaqësore.
- ✓ Treguesit e prezantuar në këtë raport tregojnë për prani të ndotësve organik dhe bakteriologjik në ujërat e lumenjve, megjithëse mundë të konstatohet që ujërat sipërfaqësore nuk janë të rrezikuara nga eutrofikimi.

- ✓ Monitorimi preliminar i aspekteve biologjike tregon vetëm një pasqyrë fillestare të kualitetit të ujërave sipërfaqësore të monitoruara, nga e cila nuk mundë të bëhet një vlerësim i plotë për cilësinë biologjike të këtyre ujërave.

Toka/dheu

- ✓ Aktualisht Kosova, nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut/tokës. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes projekteve dhe aktiviteteve periodike.
- ✓ AMMK, ka identifikuar disa lokacione të konsideruara si hotpsote mjedisore, që kanë nevojë për rehabilitim, mirëpo në mungesë të buxhetit rehabilitimi i tyre ende nuk ka filluar.
- ✓ Ndërrimi i destinimit të tokave, humbja e tokave bujqësore dhe humbja e hapësirave të gjelbra nga ndërtimet mbetet një nga sfidat kryesore mjedisore në sektorin e tokës.

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

- ✓ Përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e Kosovës.
- ✓ Ka ende zona të mbrojtura që gëzojnë status të veçantë të mbrojtjes të cilat ende nuk kanë organe menaxhuese përkatëse.
- ✓ Problem vlerësohet të jetë edhe mungesa e Planeve hapësinore, menaxhuese dhe rregulluese për disa nga këto zona.
- ✓ Nga monitorimi i faunës përmes kamerave kurthë janë marrë informacione për praninë e disa llojeve të rralla dhe të rrezikuara të faunës në Kosovë, mirëpo përkundër kësaj Kosova ende nuk e ka Librin e Kuq të faunës.
- ✓ Ka mungesë po ashtu edhe të programeve të veçanta për monitorimin e biodiversitetit në përgjithësi apo llojeve të veçanta në veçanti.
- ✓ Konsiderohen si pozitive dhe me rëndësi zbatimi i disa iniciativave dhe projekteve për menaxhimin ndërkufitarë të zonave natyrore.

Mbeturinat

- ✓ Kosova vazhdon të ballafaqohet me mungesë të menaxhimit efikas të mbeturinave. Aktualisht në nivel nacional grumbullohet rreth 60% e mbeturinave të gjeneruara. Pjesa më e madhe e tyre deponohet në deponi sanitare, ndërsa që ende nuk ka sistem të organizuar të ndarjes në burim dhe riciklimit të mbeturinave.
- ✓ Menaxhimi i deponive sanitare të Kosovës, nuk është i mirë dhe ndër problemet kryesore janë mos funksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë, kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara dhe mbulimi jo i mjaftueshëm i mbeturinave.

- ✓ Është evidentuar po ashtu edhe numër i madh i deponive ilegale në tërë territorin e Kosovës (rreth 1500 sosh), të cilat përkundër angazhimit të komunave dhe donatorëve vazhdojnë të jenë sfidë e këtij sektori.
- ✓ Aktivitetet për ndarjen në burim dhe riciklimi i mbeturinave ende janë në një shkallë të ulët.

Shëndeti publik

- ✓ Krahasuar me vitin paraprak, është regjistruar një ngritje e ndjeshme e numrit të disa sëmundjeve që ndërlidhen me aspektet mjedisore.
- ✓ Megjithëkëtë në Kosovë ende nuk ka një studim të detajuar dhe të bazuar në tregues, që do të vlerësonte ndikimin real të gjendjes së mjedisit në shëndetin publik.
- ✓ Kontroll i ujit të pijshëm i realizuar nga Instituti Kombëtarë i Shëndeti Publik tregon se rreth 98.5% e testeve kanë qenë në përputhshmëri me standardet vendore të cilësisë së ujit

Masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së mjedisit

- ✓ Kosova vazhdon angazhimin e saj në harmonizimin e legjislacionit nacional me Direktivat e BE-së, megjithëse sfidë mbetet implementimi i tij.
- ✓ Janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane veprimi për të gjithë sektorët mjedisore, mirëpo niveli i zbatimit të tyre është i pjesshëm.
- ✓ Edhe pse gjatë vitit 2017 janë shtuar aktivitetet inspektuese dhe mbikqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës, krimi mjedisor vazhdon të jetë aktivitet në rritje.
- ✓ Ndonëse është rritur buxheti për Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë për projekte kapitale mjedisore, dhe gjithashtu është rritur edhe numri i projekteve nga donatorët, çështja e mjedisit në Kosovë ende trajtohet me prioritet të ulët nga Qeveria e Kosovës.

3.2. Rekomandimet

Ajri

- ✓ Të implementohet kërkesat e Rezolutës së Kuvendit të Kosovës Nr.06-R-002, për përmirësimin e cilësisë së ajrit, nga institucionet përgjegjëse dhe të themelohen mekanizma për monitorimin e implementimit të saj.
- ✓ Të zbatohen objektivat dhe projektet e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e ajrit, e miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe nga Kuvendi i Kosovës.
- ✓ Të rritet efikasiteti i zbatimit të legjislacionit mjedisor, përmes mekanizmave dhe instrumenteve plotësuese.
- ✓ Të kompletohet inventari i emitimeve dhe burimeve të ndotësve në ajër,
- ✓ Të kompletohet dhe të funksionalizohet plotësisht sistemi nacional për monitorimin e cilësisë së ajrit me qëllim të përmirësimit të mbledhjes, përpunimin dhe raportimit të të dhënave për cilësinë e ajrit,
- ✓ Të forcohen kapacitetet teknike dhe institucionale për mirëmbajtjen e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit, servisimin dhe kalibrimin e pajisjeve si dhe të bëhet akreditimi i laboratorëve.
- ✓ Të përmirësohet bashkëpunimi në mes të institucioneve monitoruese dhe operatorëve e sidomos në procesin e rrjedhjes së informatave, përpunimit, raportimit të tyre dhe informimit më efikas të publikut për kualitetin e ajrit.
- ✓ Të hartohen politika favorizuese për shfrytëzimin e lëndëve djegëse që kanë shkarkime më të ulëta në mjedis.
- ✓ Të favorizohet shfrytëzimi i transportit alternativ që shkakton ndotje më të vogël të mjedisit dhe kufizim kohor i përdorimit të automjeteve të vjetruara dhe atyre pa katalizatorë.
- ✓ Të zbatohen aktet nënligjore mbi normat e lejuara të shkarkimit në ajër nga burimet e lëvizshme dhe nga burimet e palëvizshme.

Uji

- ✓ Të ngritet rrjeti për monitorimin e ujërave nëntokësorë dhe të bëhet monitorimi i rregullt i gjendjes së ujërave nëntokësore.
- ✓ Të behet monitorimi i parametrave biologjik të ujërave sipërfaqësore për të përcaktuar indeksin e kualitetit të ujërave sipërfaqësore.
- ✓ Të investohet në ngritjen e infrastrukturës ujore e me theks të veçante në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura.
- ✓ Të trajtohen me prioritet çështjet që ndërlidhen me adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave,
- ✓ Të vazhdohet me kompletimin e legjislacionit në sektorin e ujërave dhe transpozimit të tij me direktivat e Bashkimit Evropian.

- ✓ Të zbatohen objektivat strategjike dhe projektet e planifikuara në Strategjinë Kombëtare për Ujëra.
- ✓ Të hartohen Plane Menaxhuese për bazenet ujore.
- ✓ Të bëhen hulumtime mbi ndikimin e shfrytëzimit të ujërave për prodhimin e energjisë dhe ndikimi i tyre në zonat e mbrojtura.

Toka/dheu

- Te hartohet programi për monitorimin e përhershëm të tokave bujqësore dhe atyre industriale.
- Të hartohen politikat me të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e tokave.
- Të fuqizohet zbatimi i kornizës ligjore dhe programore për sektorin e mbrojtjes së tokave nga ndotja dhe nga ndërrimi i destinimit të të saj.
- Të hartohen programe dhe projekte për rehabilitimin e tokave të identifikuara si hot-spote mjedisore.
- Të monitorohet përdorimi i pesticideve dhe fertilizerëve në toka bujqësore.

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

- ✓ Të vazhdohet me hulumtimin, evidentimin dhe monitorimin e zonave të natyrës dhe inventarizimin e llojeve bimore e shtazore dhe habitateve natyrore.
- ✓ Të themelohen organeve menaxhuese për zonat e mbrojtura me interes të veçantë.
- ✓ Të finalizohet hartimi i Librit të faunës së Kosovës, dhe të ndërmirren masa për llojet e rrezikuara të faunës.
- ✓ Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore.
- ✓ Mbrojtja e habitateve të llojeve të rralla dhe të rrezikuara si dhe përgatitja e arsyetimeve profesionale për shpalljen e zonave të mbrojtura të zogjve dhe habitateve sipas rrjetit ekologjik Natyra 2000.
- ✓ Aprovimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna", Planit Menaxhues për Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" dhe Planeve Rregulluese.
- ✓ Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda territorit të zonave të mbrojtura të jenë në harmoni me në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233).
- ✓ Të bëhet inspektimi i vazhdueshëm nga Inspektorati i MMPH në zonat e mbrojtura.
- ✓ Të rritet numri i stafit në sektorin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.

Mbeturinat

- ✓ Të përmirësohet menaxhimi i deponive sanitare të Kosovës, dhe të zbatohet monitorimi i shkarkimeve në mjedis nga deponitë.
- ✓ Të rritet shërbimi për grumbullimin e mbeturinave komunale në tërë territorin e Kosovës.
- ✓ Komunat e Kosovës, të angazhohen në vazhdimësi për eliminimin e deponive ilegale në territorin e tyre.
- ✓ Komunat të caktojnë lokacionet për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolomi.
- ✓ Të hartohen programe dhe sisteme në nivelin nacional për ndarjen e mbeturinave në burim dhe riciklimin e tyre.
- ✓ Të përmirësohet sistemi për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për mbeturinat.

Shëndeti Publik

- ✓ Te përmirësohet mjedisi urban për te zvogëluar ndikimet negative mjedisore.
- ✓ Të investohet në shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta në zonat urbane, me qëllim të përmirësimin të gjendjes së mjedisit dhe shëndetit publik.
- ✓ Të investohet në përmirësimin e kualitetit të ujit të pijes dhe monitorimin e rregullt të tij.
- ✓ Të investohet në përmirësimin e cilësisë së ujit që ofrohet nga Kompanitë Regjionale të Ujësjellësit.
- ✓ Të rritet % e mbulueshmërisë së popullatës me shërbimin e ujësjellësit dhe me shërbimin e shkarkimit të ujërave të ndotura (kanalizimit).
- ✓ Të realizohen hulumtime lidhur me ndikimin e gjendjes së mjedisit në shëndetin publik.

Të përgjithshme

- ✓ Të riprocedohet për miratim në Qeverinë e Kosovës dhe në Kuvendin e Kosovës, Strategjia Shtetërore dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.
- ✓ Të rritet buxheti i Qeverisë së Kosovës për sektorin e mjedisit dhe veçanërisht për projektet kapitale mjedisore.
- ✓ Të themelohet ekofondi (fondi mjedisor) dhe mjetet e tij të përdoren për subvencione dhe programe për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.
- ✓ Të fuqizohet zbatimi i parimeve mjedisore e në veçanti i parimeve “ndotësi paguan” , “shfrytëzuesi paguan” dhe “parimi i masave inkurajuese” për personat juridik e fizik të cilët zgjedhin teknikat më të mira të mundshme dhe prodhimtari të pastër.
- ✓ Të fuqizohet zbatimi i legjislacionit horizontal dhe me theks të veçantë i kërkesave ligjore nga Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

4. Referencat

1. AMMK 2015, Raporti për gjendjen e ujërave 2015
2. AMMK 2016, Raporti për gjendjen e mjedisit
3. AMMK 2017, Raporti për gjendjen e ajrit
4. AMMK 2018, Menaxhimi i mbeturinave komunale në Kosovë, Raport i gjendjes
5. ARRUK 2017, Raporti i performances së kompanive të ujësjellësve dhe kanalizimeve 2017
6. ASK 2018, Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2017
7. ASK 2016, Anketa e mbeturinave industriale 2017
8. ASK 2016, Anketa e mbeturinave komunale 2017
9. ASK, Anketa e mbeturinave të trajtuara, 2016
10. ASK, Vlerësimi i popullsisë së Kosovës 2014, 2015 dhe 2016.
11. IKSHP, Cilësia e ujit të pijshëm në Kosovë 2017
12. MBPZHR 2011, Plani për bujqësi dhe zhvillim rural, 2010-2013
13. MMPH 2012, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020,
14. MMPH 2012, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e ajrit 2011-2021
15. MMPH 2014, Libri i Kuq i florës vaskulare te Republikës të Kosovës, MMPH
16. MMPH 2014, Strategjia dhe për menaxhimin e mbeturinave 2013-2022
17. MMPH 2014, Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022
18. MMPH 2015, Strategjia Kombëtare për Ujërave e Kosovës 2017-2034
19. MMPH 2015, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2014-2024
20. Monitoring transposition and implementation of the EU environmental acquis, Year 18, Progress Report 10 , Kosovo/ECRAN
21. MSH, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021
22. Raportet mujore dhe vjetore mjedisore të Departamentit të Mjedisit të KEK
23. Raporti vjetor 2013-2017, Departamenti i mjedisit, NewCoFeronikeli

5. Lista e shkurtesave, figurave dhe tabelave

5.1. Lista e shkurtesave të përdorura

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CLC	Mbulueshmëria e Tokave sipas Metodologjisë CORINE
ECRAN	Rrjeti Rregjional i Paraaderimit për Mjedis dhe Klimë
EFAS	Rrjeti Evropian i Vetëdijesimit nga Vërshimet
GHG	Gazrat e Serrës
GIZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
IHMK	Instituti Hidrometeorologjikë i Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publikë të Kosovës
IPA	Instrumenti i Para anëtarësimit i BE-së
IUCN	Unioni Ndërkombëtar i Konservimit të Natyrës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
KTOE	Kilo Ton Oil Equivalent
KUR	Kompania e Ujësjellësve Rajonal
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural
MEF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integrimeve Evropiane
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MN	Monument i Natyrës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OE	Operatorë Ekonomik
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PK	Park Kombëtar
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
REC	Qendra Regjionale për Mjedis
RM	Rezervat Natyrorë
SIDA	Agjencia Suedez për Zhvillim Ndërkombëtarë
SNK	Strategjia për Ndryshime Klimatike
SHBO	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit
TC	Termocentral
TCA	Termocentrali A
TCB	Termocentrali B

UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFCCC	Konventa Kornizë për Ndryshimin Klimatike e Kombeve të Bashkuara
ZRRUK	Zyra Rregullatorë për Ujësjellës dhe Kanalizim

5.2. Lista e figurave

Figura 1. Vlerat mesatare mujore dhe vlerat maksimale te lejuara të SO2
Figura 2. Vlerat mesatare mujore dhe vlerat maksimale te lejuara të CO
Figura 3. Vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të NO2
Figura 4. Vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të O3
Figura 5. Vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të PM10
Figura 6. Vlerat mesatare vjetore dhe vlerat maksimale te lejuara të PM10
Figura 7. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Prishtinë/IHMK
Figura 8. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Prishtinë/Rilindja
Figura 9. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Obiliq
Figura 10. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Dardhishtë
Figura 11. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Palaj
Figura 12. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Drenas
Figura 13. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Han të Elezit
Figura 14. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Mitrovicë
Figura 15. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Gjilan
Figura 16. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Pejë
Figura 17. Vlerat mestarë të PM10&PM2.5 në Prizren
Figura 18. Trendi i vlerave të Dioksidit të sulfurit (SO2)
Figura 19. Trendi i vlerave të Dioksidit të azotit (NO2)
Figura 20. Trendi i vlerave të Ozonit (O3)
Figura 21. Trendi i vlerave të monoksidit të karbonit (CO)
Figura 22. Trendi i vlerave të grimcave të pluhurit (PM10)
Figura 23. Trendi i vlerave të grimcave të pluhurit (PM2.5)
Figura 24. Emisionet e pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017
Figura 25. Emisionet e SO2 në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017
Figura 26. Emisionet e NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017
Figura 27. Emisionet e matura të pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i furrave rrotulluese
Figura 28. Emisionet e matura të SO2 në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i furrave rrotulluese
Figura 29. Emisionet e matura të NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i furrave rrotullues
Figura 30. Emisionet e matura të pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i konvertorit
Figura 31. Emisionet e matura të SO2 në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i konvertorit
Figura 32. Emisionet e matura të NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Oxhaku i konvertorit
Figura 33. Emisionet e matura të pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017 te Furra elektrike nr.1 pas skruberit
Figura 34. Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.
Figura 35. Vlera mesatare mujore e emisioneve të SO2 në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.
Figura 36. Vlera mesatare mujore e emisioneve të NOx në mg/Nm3 gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2017.
Figura 37: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjëve-IHMK 2017 (Pellgu i Drinit të Bardhë)

Figura 38: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjëve-IHMK 2017 (Pellgu i Ibrit)
Figura 39. Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjëve-IHMK 2017 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit
Figura 40. Sasia mbeturinave të deponuara 2014-2017
Figura 41. Sasia e mbeturinave të grumbulluara në kg/banor/vit
Figura 42. Trendi i deponimit të mbeturinave në deponit sanitare, te menaxhuara nga KMDK-ja për vitet 2016-2017
Figura 43. Sasia e mbeturinavë të deponuara në DS Mitrovicë dhe Pejë për vitet 2014-2017
Figura 44. Sasia e deponuar e mbeturinave për vitin 2017- Dragash & Podujevë
Figura 45. Mbeturinat e menaxhuara sipas materialit nga kompanitë që merren me trajtimin dhe përpunimin e tyre, 2016

5.3. Lista e tabelave

Tabela 1 . Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit
Tabela 2. Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimi Administrativ Nr.02/2011.
Tabela 3. Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjve 2016-2017
Tabela 4. Rezultatet e monitorimit biologjik për makroinvetebrorët
Tabela 5. Statusi ekologjik i pellgut Drini i Bardhë
Tabela 6. Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse
Tabela 7. Vlerat mesatare vjetore të prurjeve Q (l/s) sipas stacioneve matëse
Tabela 8. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive 2017
Tabela 9. Sasia e mbeturinave sipas deponive sanitare 2014-2017
Tabela 10. Krahasimi i deponive ilegale sipas komunave të identifikuara në vitin 2016 dhe 2017
Tabela 11. Sasia e mbeturinave spitalore të trajtuara për vitet 2015-2017
Tabela 12. Numri i kompanive që merren trajtimin e mbeturinave të ndryshme
Tabela 13. Sasia e mbeturinave të menaxhuara nga kompanitë që merren me trajtim/përpunim, 2016
Tabela 14. Gjithsej sasia e mbeturinave industriale të gjeneruara nga sektorët e industrisë B.C.D.E.F.G-U, 2016.
Tabela 15. Efektet në shëndet, ekosistem dhe efektet tjera në mjedis
Tabela 16. Trendet e sëmundjeve ambientale për vitet 2014-2017
Tabela 17. Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike ne përputhje me standardet cilësisë se ujit sipas KRU
Tabela 18. Transpozimi i legjislacionit nacional mjedisor me direktivat e Bashkimit Evropian
Tabela 19. Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit për sektorin e mjedisit
Tabela 20. Inspektimet dhe procedurat tjera ligjore
Tabela 21. Inicimet e AMMK në Gjykata, Prokurori, dhe Avokaturë Shtetërore
Tabela 22. Aktivitetet për Leje dhënive gjatë vitit 2017
Tabela 23. Buxheti total dhe buxheti për shpenzime kapitale i MMPH 2015-2018
Tabela 24. Projekte mjedisore të implemetuara nga buxheti i MMPH gjatë vitit 2017
Tabela 25. Projektet me donatorë në sektorin e mjedisit 2015-2017

6. Shtojcat

6.1. Shtojca 1

Parametrat fizik, kimik dhe metalet e rënda që monitorohen nga IHMK[24]

Treguesit	Simboli	Njësia	Shpeshtësia e matjeve/vit
PARAMETRAT FIZIK			
Ora	h	0:00	11
Moti	M	vrojtim	11
Temperatura e ujit	Tu	0C	11
Temperatura e ajrit	TA	0C	11
Aroma	Ar	nuhatje	11
Ngjyra	Ngj	Co/Pt	11
Turbullira	Tur	NTU	11
Përçueshmëria elektrike	χ	µScm-1	11
Materiet e tretshme në ujë	M.tert.	mg/l	11
Përqendrimi i jonit hidrogjen	pH	0-14	11
PARAMETRAT KIMIK			
Oksigjeni i tretur	OT	mg/l O2	11
Ngopja me oksigjen	NgO	%	11
Shpenzimi kimik i oksigjenit	SHKO	mg/l O2	11
Shpenzimi kimik i oksigjenit me dikromat	SHKO-Cr	mg/l O2	11
Shpenzimi biokimik i oksigjenit	SHBO5	mg/l O2	11
Shpenzimi biokimik i oksigjenit	SHBO7	mg/l O2	11
Karboni organik total	KOT	mg/l C	11
Materiet totale të suspenduara	MTS	mg/l	11
Detergjentet	DET	mg/l	11
Joni nitratet	NO3-	mg/l	11
Azoti i nitrateve	N-NO3-	mg/l N	11
Joni nitrik	NO2-	mg/l	11
Azoti i nitrateve	N-NO2-	mg/l N	11
Joni amonium	NH4+	mg/l	11
Azoti i amoniumit	N-NH4+	mg/l N	11

[24] *Vetëm parametrat e hijëzuar me të kaltër janë vlerësuar dhe prezantuar në këtë raport.*

Azoti total inorganik	ATI	mg/l N	11
Amoniumi i pa jonizuar	NH3	mg/l	11
Azoti i amoniumit te pa jonizuar	N-NH3	mg/l N	11
Azoti total organik + inorganik	AT	mg/l N	11
Azoti total organik	ATO	mg/l N	11
Orto fosfatet	PO43-	mg/l	11
Fosfori i orto fosfateve	P - PO43-	mg/l P	11
Fosfori total (poli + orto)	Ptot.	mg/l	11
Joni sulfat	SO42-	mg/l	11
Fortësia e përgjithshme	Fp	0dH	11
Fortësia e Kalciumit	Fca	mg/l	11
Fortësia e Magnezit	FMg	mg/l	11
Jonet e Kalciumit	Ca+	mg/l	11
Jonet e Magnezit	Mg+	mg/l	11
P-Alkaliteti	Pa	ml 0.1 e HCl	11
M-Alkaliteti	Ma	ml 0.1 e HCl	11
Alkaliteti total	AT	mmol/l HCl	11
Bikarbonatet	HCO3-	mg/l	11
Klori i lirë	Cl2	mg/l	11
Kloruret	Cl-	mg/l	11
Silikatet	SiO32-	mg/l	11
Silici në Silikate	Si - SiO32-	mg/l Si	11
Klorofil a	Chlorophyll a	µg/l	11
Fenolet	C6H5OH	mg/l	11
METALET E RËNDA			
Kromi	Cr3+	µg/l	2
Kadmiumi	Cd2+	µg/l	2
Nikeli	Ni2+	µg/l	2
Zinku	Zn2+	µg/l	2
Mangani	Mn2+	µg/l	2
Bakri	Cu2+	µg/l	2
Hekuri	Fe2+	µg/l	2
Plumbi	Pb2+	µg/l	2

6.2. Shtojca 2

Kodet e stacioneve të monitorimit të kualitetit fiziko-kimik të ujërave sipërfaqësore- lumenjtë

Kodi	Lokacioni	Lumi	Venderdhja
RV01_011	Radavc	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_012	Klinë	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_013	Gjonaj	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_014	Vermicë	Drini i Bardhë	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_021	Istog	Istogu	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_022	Zllakuçan	Istogu	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_031	Stërnac i ulët	Klina	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_032	Klinë	Klina	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_041	Drelaj	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_042	Pejë dalje	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_043	Grabanicë	Lumbardhi i Pejës	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_051	Banjë e Malishevës	Mirusha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_052	Volljakë	Mirusha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_061	Deçan Hyrje	Lumbardhi i Deçanit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_062	Kralan	Lumbardhi i Deçanit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_071	Jasiq	Ereniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_072	Ura e Terzive	Ereniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_081	Zhdrellë	Rimniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_082	Xërxë	Rimniku	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_091	Buqallë	Toplluha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_092	Piranë	Toplluha	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_101	Prevallë	Lumbardhi i Prizrenit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV01_102	Vllashnje	Lumbardhi i Prizrenit	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV02_011	Kushtovë	Ibri	Deti i Zi
RV02_012	Mitrovicë	Ibri	Deti i Zi
RV02_013	Kelmend	Ibri	Deti i Zi

RV02_021	Bablak	Sitnica	Deti i Zi
RV02_022	Lipjan	Sitnica	Deti i Zi
RV02_023	Vragoli	Sitnica	Deti i Zi
RV02_024	Plemetin	Sitnica	Deti i Zi
RV02_025	Nedakovc	Sitnica	Deti i Zi
RV02_026	Mitrovicë	Sitnica	Deti i Zi
RV02_031	Marincë	Llapi	Deti i Zi
RV02_032	Podujevë	Llapi	Deti i Zi
RV02_033	Milloshevë	Llapi	Deti i Zi
RV02_041	Bresje	Prishtevka	Deti i Zi
RV02_051	Vragoli	Graqanka	Deti i Zi
RV02_061	Pjetërshticë	Drenica	Deti i Zi
RV02_062	Vragoli	Drenica	Deti i Zi
RV02_062B	Drenicë	Çikatovë e Vjetër	Deti i Zi
RV02_071	Devetak	Shtime	Deti Mesdhe/Deti Adriatik
RV02_072	Vojnovc	Shtime	Deti i Zi
RV03_011	Korbuliq	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_012	Kllokot	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_013	Ranillugë	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_014	Domoroc	Morava e Binçës	Deti i Zi
RV03_021	Marec	Kriva reka	Deti i Zi
RV03_022	Domoroc	Kriva reka	Deti i Zi
RV04_011	Prevallë Subain	Lepenci	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_012	Kaçanik	Lepenci	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_013	Hani i Elezit	Lepenci	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_021	Jezerc	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_022	Bifurkacioni	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_023	Gërlicë	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje
RV04_024	Kaçanik	Nerodimja	Deti Mesdhe /Deti Egje

Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, është përgatitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Adresa e AMMK-së:
Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04
Tel. +381 38 200 33 228 , email: ammk@ks-gov.net

Prishtinë, Qershor 2018